

**VLERESIMI I IMPAKTIT MJEDISOR  
PËR**

**KOMUNITETIN ENERGHJITIK TË EUROPES JUGË LINDORE  
APL 5- PROJEKTI I SIGURISË SË DIGAVE NË SHQIPËRI**

**REHABILITIMI I  
HIDROÇENTRALIT TË ULZËS**

## Tabela e përmbajtjes

<b>1</b>	<b>HYRJE</b> .....	<b>5</b>
1.1	Qëllimi i studimit .....	5
<b>2</b>	<b>PËRSHKRIMI I PROJEKTIT</b> .....	<b>6</b>
2.1	Objektivat e Projektit .....	6
2.2	Vendndodhja e Projektit.....	7
2.3	Perbersit e Projektit.....	8
<b>3</b>	<b>PËRSHKRIMI I HIDROÇENTRALIT TË ULZËS</b> .....	<b>10</b>
3.1	Investimet simbas projektit dhe gjendja aktuale.....	12
3.1.1	Sistemi i Monitorimit të Digës .....	12
3.1.2	Sistemi i alarmit të Digës.....	13
<b>4</b>	<b>KUSHTET MJEDISORE BAZË</b> .....	<b>14</b>
4.1	Mjedisi fizik.....	14
4.1.1	Gjeologjia.....	14
4.1.2	Ujrat Sipërfaqësore .....	15
4.1.3	Ujrat Nëntokësore .....	16
4.1.4	Cilësia e Ujrave .....	16
4.1.5	Ndotja e Tokës .....	16
4.1.6	Cilësia e Ajrit dhe Emtimi në Ajër .....	17
4.1.7	Emetimi i Zhurmave.....	17
4.1.8	Impakti Pamor .....	16
4.2	Meteorologjia.....	17
4.2.1	Temperaturat .....	18
4.2.2	Rreshjet .....	18
4.2.3	Sjellja e erës .....	19
4.3	Mjedisi biologjik .....	19
4.3.1	Flora .....	19
4.3.2	Fauna .....	20
4.3.3	Siperfaqet Natyrore të Mbrojtura.....	20
4.4	Mjedisi social-ekonomik.....	21
4.4.1	Bujqësia dhe Blegtoria.....	21
4.4.2	Të Ardhurat dhe Standardi i Jetës .....	22

4.4.3	Burime të Tjera të Ardhurash .....	22
<b>5</b>	<b>LEGJISLACIONI MBI MJEDISIN DHE PROÇEDURAT MBROJTËSE .....</b>	<b>22</b>
5.1	Proçedurat mbrojtëse të Bankës Botërore.....	22
5.2	Legjislacioni Shqiptar mbi mjedisin .....	23
<b>6</b>	<b>IMPAKTET POTENCIALE NË MJEDIS .....</b>	<b>25</b>
6.1	Impaktet ne Mjedis gjatë Fazës Ndërtimore.....	25
6.2	Impaktet ne Mjedis gjatë Fazës Operative.....	27
<b>7</b>	<b>PLANI I MENAXHIMIT TË MJEDISIT .....</b>	<b>27</b>
<b>8</b>	<b>KAPACITETI INSTITUCIONAL .....</b>	<b>32</b>
8.1	Forcimi i kapacitetit institucional për projektin .....	33
<b>9</b>	<b>PJESMARJA E PUBLIKUT .....</b>	<b>35</b>
<b>10</b>	<b>SHTOJCA .....</b>	<b>37</b>
10.1	Shtojca 1 Vizatimet skematike të HC të Ulzës .....	37
10.2	Shtojca 2 Përmbledhja e Raportit të VNM.....	38
10.3	Shtojca 3 Plani i Veprimit për Kontrollin e Prevenimin e Derdhjeve, dhe Kundërmasat për Lehtësimin e KESH-it.....	398
10.4	Shtojca 4 Plani i Veprimit të Emergjencës .....	39
10.5	Shtojca 5 Plani i Veprimit në Rast Mbetjesh të Rezikshme.....	410
10.6	Shtojca 6 Roli i Organeve Shtetërore që lidhen me Mjedisin .....	421

**Figurat:**

Figura 1	Vendndodhja e HC të kaskadave të lumenjve Drini Dhe Mati .....	8
Figura 2	Vendosja e HC të Ulzës.....	11
Figura 3	Diga gravitative prej betoni e Ulzës.....	12
Figura 4	Harta gjeologjike-tektonike e shesheve të Ulzës dhe Shkopetit .....	15
Figura 5	Pylli në të dy anët e Digës së Ulzës .....	19
Figura 6	Harta e zonave të mbrojtura të Shqipërisë së Veriut .....	21

**Tabela:**

Tabela 1	Temperaturat mesatare mujore në °C dhe rreshjet mesatare mujore në mm për Stacionin Klimatik të Burrelit.....	18
Tabela 2	Masat Lehtësuse Mjedisore për Fazën e Ndërtimit.....	29
Tabela 3	Plani i Monitorimit të Mjedisit.....	30

Tabela 4 Përgjësjetë për mjedisin gjatë ndërtimit dhe funksjonimit .....34

Hyrje. Hidrocentralet e Shqipërisë (HCSH) në Kaskadat e lumenjve Drini dhe Mati janë një pasuri shumë e çmueshme për vendin. Ato prodhojnë mbi 90% të energjisë elektrike të vendit dhe furnizojnë mbi 65% të nevojave për energji elektrike të vendit. Në një vit mesatar, Shqipëria prodhon rreth 4.2 GWh energji elektrike.

Kjo infrastrukture e madhe ka qënë monitoruar dhe mirëmbajtur në mënyrë të pamjaftueshme për më shumë se 15 vjet dhe mund të paraqitë risk të konsiderueshëm për vendin. Duke ndjekur paralajmërimet e Bankës Botërore për këtë çështje, nga Sekretariati Zvicerian i Çështjeve Ekonomike (SECO) u formua një Shërbim i Sigurisë së Digave për Hidrocentralet e Kaskadave të Lumenjve Drin dhe Mat, i cili u kompletua në vitin 2006. Ky Shërbim identifikoi një numër mungesash serioze dhe erdhi në përfundimin se *"gjendja e sotme e sigurisë së digave është e pa sigurtë, dhe një fatkeqësi ... mund të konsiderohet si e mundëshme ... nëqoftëse gjërat lihen të përkeqësohen më tej"*. Si formimi institucional edhe monitorimi po ashtu edhe gjendja fizike e infrastruktures u gjetën se kanë nevojë për përmirësime të rëndësishme.

Mbështetja për digat e HC të Shqipërisë është e nevojshme jo vetëm për risqet e sigurisë që ato mbartin, por edhe për përmirësimin e përgjithshëm të funksionimit të tyre si dhe për të lehtësuar integrimin e vendit me sistemin e regjional të elektricitetit. Për shkak të kapacitetit të madh grumbullues të digave, vendi mund të përdorë resurset hidrike të veta për të optimizuar furnizimin me energji elektrike kur të integrohet në pazarin rajonal. Shqipëria është anëtar i Komunitetit të Energjisë të Evropës Jugë Lindore (KEEJL), dhe një sërë investimesh të planifikuara do ndihmojnë të përmirësojë pjesmarjen e saj në pazarin rajonal të energjisë elektrike. Pë më tepër, duke u adresuar në sigurinë nga risqet të digave egzistuese mund të krijohen opsione të vlefshme për sa i përket operimit të ardhëshëm dhe pronësisë së aseteve hidroelektrike.

Pjesa më e madhe e përfundimeve mbi gjendjen e paisjeve/digave dhe punimet e propozuara së bashku me fotografitë dhe vizatimet janë marre me miratimin e KESH-it nga Shërbim i Sigurisë së Digave për Hidrocentralet e Kaskadave të Lumenjve Drin dhe Mat.

## 1.1 QËLLIMI I STUDIMIT

Qëllimi i këtij studimi është të kryej një vlerësim mjedisor (VM) për projektin e propozuar ESCEE APL 5 Albania Project - Dam Safety (Projekti për Shqipërinë - Siguria e Digave) që të implementohet në Digat e Lumenjve Drin dhe Mat në Shqipëri. Vlerësimi duhet të bëhet me pesë vlerësime ndikimi në mjedis (VNM) të veçanta për çdo një nga pesë digat. Qëllimi i VNM është që të sigurojë se investimet e propozuara që do implementohen nëpërmjet Projektit të përputhen me ligjet egzistuese të mbrojtjes së mjedisit, rregulloret dhe standartet e Shqipërisë si dhe me Politikën Operuese dhe Praktikën e Bankës Botërore; dhe nuk do kenë një impakt të kundërt në popullsinë e vendit, në mjedisin natyror ose në objektet me vlera të veçanata të trashëgimisë kulturore. VNM kërkon që të

bëhet për të përcaktuar masat që do implementohen sikurse përcaktohen në kapitullin 2.3 të këtij raporti, dhe kjo kërkon që hidrocentralet do meren në konsiderate si pjesë e gjendjes së sotme, dhe VNM do fokusohet në efektet mjedisore (positive dhe negative) të masava që do implementohen simbas këtij projekti.

Përderisa studimi i besueshmërisë dhe dokumentacioni teknik që e shoqëron është ende i pa përfunduar, do të kërkohej një revisioni i kësaj VNM nëqoftë se studimi do sugjerojë zgjidhje që nuk janë në të njëjtën linjë me VNM e dhënë. Dokumenti I ri duhet të rishikohet edhe një here.

Ky raport paraqit VNM për punimet e parashikuara në HC e Ulzës.

## 2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Mirëmbajtja dhe riparimi i digave të vendit duhet të bëhet urgjentisht. Ka një sërë paqartësish lidhur me atë në se kushtet aktuale dhe praktikat e operimit të digave do ti rezistonin një ngjarjeje moti të jashtëzakonshëm e cila mund të ndodhë si pasojë e rritjes së risqeve nga ndryshimet klimatike. Qeveria Shqiptare (QSh) e njej nevojën e adresimit të çështjeve të sigurisë të hidrocentraleve dhe i ka kërkuar Bankës ndihmë për të përmirësuar sektorin në fjalë.

Shërbimi i Sigurisë së Digave më 2006 ka rekomanduar një sërë investimesh për përmirësimin e sigurisë dhe funksionimit të digave dhe i ka kategorizuar ato në masa me: (i) prioritet shumë të lartë, prioritet të lartë dhe prioritet mesatar (Euro 28m); dhe (ii) prioritet i lartë i kushtëzuar (Euro 153m). Projekti do financojë investimet me prioritet shumë të lartë, prioritet të lartë dhe prioritet mesatar të cilat janë definuar më me përpikmëri dhe kanë nevojë për studime të vogla të mëtejshme.

Këto investime përfshijnë punimet për rehabilitimin e sigurinë e funksionimit normal të shkarkuesve, instalimin e sistemeve siguruese të alarmit për kujdesin ndaj përmytjeve dhe monitorimit gjeodezik, rehabilitimin e paisjeve elektromekanike, instrumenta dhe paisje monitoruese. Ndoshta në të ardhmen do duhen punime plotësuese dhe investime për disa masa me prioritet mesatar dhe të lartë për të kompletuar masat e sigurisë së digave të cilat do studjohen më tej gjatë implementimit të projektit. EBRD ka pranuar të financojë për çdo investim të mëtejshme lidhur me sigurinë sikurse janë përcaktuar me saktësi nga një projekt deri në Euro 30m. Nevojat dhe përafrimet alternative për masat e prioritetit të lartë (ii), do të vlerësohen gjatë implementimit të projektit.

Objektiavet e Projektit

Objektivat e zhvillimit të projektit janë të: (i) të ruajë (mbrojtë) hidrocentralet e Shqipërisë dhe (ii) të përmirësojë efikasitetin e tyre veprues dhe integrimin me **pazarin** regjional të energjisë elektike. Projekti i propozuar mbështet zhvillimin e Komunitetit Energjistik në përputhje me objektivat e Komunitetit Energjistik të APL.

Impakti kryesor i projektit do jetë të parandalojë një katastrofë të mundëshme nga një dëmtim i digës. Një katastrofë e tillë mund të rezultojë në humbje të mëdhe njerzish dhe të pasurisë së njerëzve që jetojnë në pjesët e poshtëme të rrjedhjeve lumore. Ajo mund të shkaktojë gjithashtu një rënie të madhe dhe të gjatë të prodhimit të energjisë elektrike që do ndikojë rëndë në gjithë popullsinë e Shqipërisë dhe do të bëjë që çmimi i energjisë të rritet shtëpërmirë në gjithë rajonin e Europës Jugë Lindore. Njerzit e varfër e të pambrojtur të rajonit do vuajnë në mënyrë disproporcionale nga çdo ngritje e tillë çmimi i energjisë elektrike.

Në vazhdimësi, projekti do të ndihmojë Shqipërinë të rritë fitimet e veta nga energjia elektrike egzistuese nëpërmjet përmirësimit të praktikës prodhuese e paisjeve egzistuese që do mundësojë pjesmarjen më efektive në pazarin rajonal të energjisë elektrike. Projekti do të promovojë investimet e sektorit privat në hidroenergjitikë nëpërmjet mbledhjes, organizimit, dhe mundësimit të studimit dhe të dhënave më të mira të potencialit hidroenergjitik të vendit.

## 2.1 VENDNDODHJA E PROJEKTIT

Projekti do implementojë masat përmirësuese në HC-et e Kaskadave të lumenjve Drini Mati. Lumi i Drinit është lumi më i madh i Shqipërisë, me një sipërfaqe të përgjithëshme ujëmbledhëse prej 14 173 km<sup>2</sup>, ndërsa lumi i Matit, me një gjatësi të përgjithëshme rreth 115 km, ka një pellg ujëmbledhës prej 2 441 km<sup>2</sup>. Kaskada e lumit Drini përbëhet nga tre hidrocentrale, ai i Fierzës, i Komanit dhe të Vaut të Dejës. Këto diga janë ndërtuar gjatë viteve 1967 deri 1985. Diga e Fierzës, më e larta në kaskadën e Drinit është një digë dheu me berthame argjilore me lartësi 177 m, me një volum aktiv ujëgrumbullimi prej 2700 mil m<sup>3</sup>. rezervuari i krijuar nga diga e Fierzës shërben si një rezervuar presioni për kaskadën e lumit Drini. Diga e Komanit, e dyta në këtë kaskadë ka lartësi 115 m dhe është me mbushje gurësh dhe me sipërfaqe të betonuar me volum 430 mil m<sup>3</sup> dhe që vendoset 2 km larg nga fshati Koman. Vau i Dejës ndodhet në pjesën e poshtëme të luginës së lumit Drini në largësi rreth 18 km nga qyteti i Shkodrës. Hidrocentrali përfshin tre diga të veçanta. Kaskada e lumit Mati përbëhet nga dy hidrocentrale: Ulza dhe Shkopeti të ndërtuara nga 1952 deri 1963. HC i Ulzës vendoset afër fshatit Ulza dhe Burrelit. Ai përfaqëson një digë gravitative prej betoni me lartësi 64 m me aks të drejtë me volum grumbullues prej 240 mil m<sup>3</sup>. Rezervuari i krijuar shërben si rezervuar presioni për kaskadën e lumit Mati. Diga e Shkopetit e cila është gravitative prej betoni ka lartësi 50 m dhe një volum grumbullues prej 40 mil m<sup>3</sup>.

Vendndodhja e digave tregohet në Figura 1.




Figura 1 Vëndndodhja e HC-ve të kaskadës së lumenjve Drini dhe Mati

## 2.2 PËRBËRSIT E PROJEKTIT

Projekti do konsistojë në dy komponentet kryesorë: (1) investimet në infrastrukturë; dhe (2) ndihma teknike.

### Komponenti 1: Investimet në Infrastrukturë

Masa Përmirësuese me Prioritet Shumë të Lartë (Euro 3 milion): (i) Sistemi i Alarmit i Sigurimit të Digës për Pellgjet e Lumenjve Drini dhe Mati përfshijnë specifikimin dhe implementimin e sistemeve të alarmit në pellgjet e Lumenjve Drini dhe Mati, dhe specifikimin e një Plan Veprimi të Emergjencës (Euro 2 milion); (ii) Sistemi i Monitorimit të Digave për Pellgjet e Lumenjve Drini dhe Mati përfshin specifikimin dhe implementimin e paisjeve të monitorimit të digave përfshi GPS, dhe implementimin e një sistemi grumbullimi të dhënash (Euro 1 milion).

Masa Përmirësuese me Prioritet të Lartë (Euro 4.8 milion): (i) Diga e Fierzës - Rehabilitimi i portes se shkarkimit no. 3 (Euro 2.8 milion); (ii) Sistemi i Monitorimit Gjeologjik në Fierzë dhe Koman - përfshin specifikimin dhe implementimin e sistemit të alarmit të levizjeve/rrëshqitjeve të lidhura me GPS për identifikimin e zonave gjeologjike potencialisht rëshqitëse (Euro 1.6 milion); (iii) Vau i Dejes - Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e portave te shkarkimit (Euro 0.3 milion); (iv) Departamenti i Sigurimit të Digave në KEH - Paisje për arkivën e të dhënave, vrojtimin dhe dokumentacionin (Euro 0.1 milion).

Masa Përmirësuese me Prioritet Mesatar dhe Përmirësime Operative (Euro 7 milion): (i) Diga e Komanit - Rehabilitimi i përgjithshëm i gominavet te portave te shkarkimit, si dhe të kornizave, cilindrave dhe të paisjeve hidraulike. (Euro 0.5 milion); (ii) Diga e Komanit - Rehabilitimi i paisjeve elektromekanike. (Euro 5

milion); (iii) Diga e Vaut të Dejes - implementimi i Sistemit të Kontrollit të frekuencës që lejon integrimin e sistemit të energjisë elektrike të Shqipërisë me UCTE (Euro 1.5 milion).

## **Komponenti 2: Ndhma Teknike dhe Trainimi**

Analiza Hidrologjike dhe Menaxhimi i Ujit (Euro 1.5 milion). Duke u fokusuar tek KESH-i dhe në pellgjet e lumenjve Drini dhe Mati projekti do të japë ndihmë teknike për zhvillimin dhe trainimin e KESH-it në fushën e menaxhimit të integruar të rezervave ujore për sa i përket pellgjeve ujore të lumenjve Drini dhe Mati dhe për optimizimin e dispeçerizimit të prodhimit dhe menaxhimit të rezervave ujore. Siguria e digave, infrastruktura ujore, dhe energjia ujore janë të qënësishme për sa i përket menaxhimit të ujit. Mirpo, për shkak të mirëmbajtjes së keqe dhe dobësisë institucionale në Shqipërisë, mbas tranzicionit të vendit, njohuritë dhe praktika për menaxhimin e ujit është neglizhuar dhe janë krijuar prapambetje të mëdha. Prandaj projekti për të aritur objektivat e veta do të japë ndihmë teknike për: (i) përmirësimin e kualitetit të sigurimit dhe të dhënave hidrologjike, analizës dhe modelimit; (ii) studimin e mundësisë të ndryshimit të rregullave operative për sigurimin e ritjes së përfitimeve ekonomike, mjedisore dhe sociale, dhe (iii) përfshirja e implikimeve të ndryshimeve klimatike për sa i përket problemeve hidrologjike. Një pjesë të kësaj punë analitike ka filluar gjatë përgatitjes së projektit dhe do vazhdojë gjatë implementimit të projektit.

Ekipi i projektit ka koordinuar me axhensitë bilaterale të ndihmave (SECO dhe SIDA) për ecurinë e projekteve që rritin aftësitë e vendit lidhur me menaxhimin e ujit. Projektet e Bankës Botërore lidhur me Menaxhimin e Fatkeqësive dhe Lehtësimin e Risqeve për Europën Jugë Lindore po ndihmon gjithashtu në drejtim të monitorimit më të mirë të motit dhe hidrologjik në nivel vëndi.

Konsulentët për Implementimin e Projektit (Euro 2.5 milion). Projekti do kërkojë konsulentë të specializuar gjatë implementimit për të ndihmuar KESH-in për prokurimet, përpilimin, dhe supervizionin e kontratave të ndryshme.

Forcimi Institucional (Euro 0.4 milion). Zhvillimi i kulture së Sigurisë së Digave në vetë KESH-in dhe forcimi institucional i Komisionit Shqiptar të Digave të Larta (AlbCOLD) është një kërkesë për qëndrueshmërinë e implementimit afat gjatë të masave të sigurisë. Ndhma teknike do të jepet për të përforcuar kapacitetet teknike të departamentit të sigurisë së digave në KESH dhe të Komitetit të Digave të Larta.

Studimi për zhvillime të reja të energjisë ujore (Euro 2 milion). Shqipëria ka një zhvillim të ulët të potencialeve të energjisë ujore e cila po të zhvillohet do të sigurojë kapacitete plotësuese për vendin dhe për sistemin regional të energjisë elektrike. Rreth lumit Drin me sa duket ka potenciale për zhvillim të mëtejshëm, ose opsionet e pompim-grumbullimit. Për të përcaktuar kostot fillestare të studimeve të besueshmërisë ky komponent i ndihmës teknike do të financojë studimet e detajuara të besueshmërisë për zhvillimet e raja hidroenergjitike në Shqipëri.

Rritja e Kapacitetit të Menaxhimi Financiar të KESH-it (Euro 0.5 milion). KESH-i, në përputhje me Trajtimi Komunitar i Energjise po thellon më tej decentralizimin. Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) që nga viti 2006 është bërë një njësi e pamvarur, ndërsa një kompani Operatore e Sistemit të Shpërdarjes (OSSH) është legalizuar që nga viti 2007. Aktualisht OST është plotësisht e pronësuar nga KESH, ndërsa OSSH është në procesin e privatizimit. Këto ndryshime kanë krijuar nevojën për një raportim financiar më të mirë sambas Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-IFRS) për të përmirësuar monitorimin sektorial dhe regullat. Mirpo, KESH ka kapacitet të kufizuar për monitoruar transaksionet e veta financiare dhe për të përgatitur raporte financiare të përshtatëshme. Ky komponent do trajtohet më poshtë.

Paneli i ekspertëve për Sigurinë e Digave (Euro 0.2 milion). Për mbikqyrjen e formulimit dhe implementimit të ndërhyrjeve të ndryshme në digat e përfshira në projekt, si dhe në politikat e Sigurisë së Digave, kërkohet një panel ekspertësh të pamvarur. Ky komponent do të financojë punën e këtyre ekspertëve të pamvarur.

### **3 PËRSHKRIMI I HIDROCENTRALIT TË ULZËS**

Diga e Ulzës ndodhet afër fshatit Ulza dhe Burrelit, dhe është diga më e lartë e Kaskadës ë Matit që përfshin digat e Ulzës dhe Shkopetit. Diga e Ulzës është ndërtuar në perjudhën e viteve 1952 deri 1958.

Ajo është një digë graviteti prej betoni me aks të drejtë. Mosfiltrimi i ujit në digë është realizuar me anë të një perde çimentoje. Lartësia maksimale e digës mbi themel është 64.2 m dhe kurora ka gjatësi 260 m. Lartësia e kurorës është 131.7 m mbi nivelin e detit (mnd) dhe niveli maksimal i ujit në rezervuar është 129.5 m mnd. Niveli minimal i themelit është 67.5 m mnd. Volumi i digës është 0.26 milion m<sup>3</sup>. Ardhja mesatare vjetore në rezervuar është 1.170 million m<sup>3</sup>. The reservoir total storage is 240 milion m<sup>3</sup> dhe volume aktiv është 124 million m<sup>3</sup>. Niveli maksimal i ujit është 129.5 m mnd, ndërsa niveli maksimal dobishëm është pak m1 l ulët, afërsisht 128.5 m asl. Niveli minimal i dobishëm është 117 m mnd.

Shkarkuesit përdoren për kalimin e prurjeve të larta dhe përbëhet nga 4 hapësira me porta radiale. Niveli i kurorës të shkarkuesve është 109 m mnd. Kapaciteti shkarkimit për nivelin maksimal të shkarkimit është 2160 m<sup>3</sup>/s ndërsa rrjedhja maksimale e për nivele të larta është 1200 m<sup>3</sup>/s.

Ndërtesa e centralit është e inkorporuar në trupin e digës dhe ka 4 turbina me kapacitet të përgjithshëm prodhimi prej 4\*6.3 MW. Rrjedhja e centralit është 4x16 m<sup>3</sup>/s. Presioni neto nominal është 54.80 m. Prodhimi mesatar vjetor i energjisë është 120 GWh dhe koeficienti i centralit është 51%.

Figura 2 jep plan-vendosjen e digës së Ulzës (1- digë betoni graviteti 2-shkarkues; 3- Vepra e marjes; 4- Lumi Mati; 5- rezervuar; dhe 6- nenstacioni

Anksi 1 paraqit skica plotësuese skematike të digës së Ulzës të përgatitura nga Electrowatt Econo Ltd dhe të cilat janë pjesë e Studimit të Sigurisë së Digave.




Figura 2 Plan-vendosja e HC të Ulzës



Figura 3 Diga gravitative prej betoni e Ulzës

### **3.1 INVESTIMET SIMBAS PROJEKTIT DHE GJENDJA AKTUALE**

Projekti në HC e Ulzës do financojë a) instalimin e Sistemit të Monitorimit të Digës; dhe b) instalimin e Sistemit të Monitorimit të Digës me përgatitjen e Planit të Veprimit të Emergjencës.

#### **3.1.1 Sistemi i Monitorimit të Digës**

Kontrolli i sigurisë të një dige të madhe mbështetet në analizën e sjelljes së strukturas, bazuar në monitimin e një sërë variablash të cilët përcaktojnë marëdhëniet ndërmjet vepruesve (gravitetit, temperaturës, presionit hidrostatik etj.) dhe reaksionit përgjegjës të strukturas (dridhjet, çvendosjet, etj.) duke marrë në konsideratë materialet e përdorura në ndërtim (beton, prita dheu, mure guri etj.).

Sistemit i Monitorimit të Digës aktualisht është në gjendje të pakënaqëshme. Disa nga instrumentat egzistues nuk punojnë më për shkak të mirëmbajtjes së dobët. Për më tepër të dhënat e regjistruara, nëqoftëse egzistojnë, nuk janë vlerësuar rregullisht.

Diga e Ulzës ka 8 pika gjeodezike, 10 tuba piezometra, dhe pesë qeliza drenimi aktualisht në funksionim. Për fat të keq, nuk ka matje të cilat të mund të

hetohen os të bëhet një vlerësim i përafërt i saktësisë së tyre. Dushohet në se këto paisje ende funksionojnë. Numri fillestar i propozuar i instrumentave mates (tuba piezometra, dhe gropa drenimi) ka qënë 20. KESH dhe konsulentët për sigurinë e digës kanë rekomanduar të rivendosen instrumentat, pamvarsisht se instrumentat egzistues mundet gjithashtu të përdoren nëqoftëse mund të demostrohët se matjet e marra prej tyre janë të besueshme. Galeria e drenimit është e përmbytur dhe nga galeria e instrumentave ka rrjedhje të vazhdueshme uji.

Çvendosja e trupit të digës duhet të monitorohet. Të pakën 15 pika të tjera gjeodezike do jenë të nevojshme për të krijuar një rrjetë mjaftueshmërisht të plotë për vrojtimin e çvendosjes të kurorës, faqeve të digës, galerive dhe pikave mbështetëse. Gjithashtu është sugjeruar që të instalohen tre vija pingule për matjen e çvendosjes të digës kundrejt themelit. Këto mund të instalohen nga galeria më e ulët.

Gjithë shkarkimet e ujit nga ana e poshtëme e perdes së çimentimit, d.m.th. kryesisht në pjesën fundore kembes se diges të digës duhet të grumbullohet dhe të matet. Numri i paisjeve dhe i pikave grumbulluese duhet të përcaktohet më tej.

Efektiviteti i perdes së çimentimit (vrojtimi i presionit të ujit të poreve) duhet të kontrollohet si nevojë e shtimit të monitorimit me rritjen e moshës së digës.

Presioni i poreve në shkëmbinjtë pikërisht nën bazën e digës duhet të monitorohet me anë të manometrave në qoftë se presioni është më i lartë se lartësia e majës së piezometrave. Është rekomanduar që të instalohen thjetë piezometra në galerinë e poshtëme (fundore) dhe gjashtë të tjerë në të dy shpatullat.

Regjistrimet e monitorimit sistematikisht do ruhen në një sistem të ri automatic të mbajtjes të të dhënave, duke përdorur gjithashtu një Sistem (GIS). Të dhënat e rgjistruara do të kontrollohen periodikisht nga inxhinierët e digës dhe gjeologët.

### **3.1.2 Sistemi i Alarmit të Digës**

Sistemi i Alarmit të Digës aktualisht nuk është në efiçencë dhe nuk ka organizim për të dhënë një përgjigje të shpejtë për këtë. Sistemi i alarmit duhet të lidhet me paisjet monitoruese dhe me GIS.

Sistemi i alarmit duhet të projektohet në mënyrë që sa më pare që të jetë e mundur të operoje dhe të sigurojë stafin që punon në HC dhe gjithashtu dhe popullsinë e rrezikuar gjatë rrejdhes në rast problemesh serioze me një ose më shumë nga digat egzistuese. Alarmi do jepet në rastet e skenarëve më të këqinj të shkatërimit të digës por gjithashtu edhe, për shëmbull, në raste të lëshimit të menjëhershëm të ujrave të tepërta përmbytëse ose dëmtimit të strukturës së digës nga tërmetet. Qëllimi kryesor i një sistemi alarmi është që të paralajmërohet në kohë popullsia që riskohet menjëherë sa jepet një alarm.

Besueshmëria e sistemit të alarmit dhe mënjanimi i alarmeve false për ata janë shumë të rëndësishme për një sistem alarmi të besueshëm.

Për digën e Ulzës do përpunohet Plani i Veprimit të Emergjencës. Ky plan do paisë KESH-in dhe Qeverinë me një guide për identifikimin dhe monitorimin, që i përgjigjet dhe lehtëson situatat emergjente. Ajo duhet të përcaktojë “kush do bëjë çfarë, ku, kur, dhe si” në një situatë emergjence ose në çdo gjendje jo të zakonshme që lidhet me digën.

## **4 KUSHTET MJEDISORE BAZË**

### **4.1 MJEDISI FIZIK**

Zona ku është vendosur Diga e Ulzës dhe Liqeni i Ulzës përfaqësojnë pjesën qendrore të Luginës së Lumit Mati, afër fshatit Ulza dhe Burrelit. Zona përfaqëson një depresion me lartësi e cila ulet qetë drejt Luginës së Lumit Mati nga lartësitë rreth 500 m mnd deri në rreth 80-120 m mnd. Relievi është shumë i fragmentarizuar nga shumë përrrenj të vegjël e të thellë të cilët rrjedhin drejt Lumit Mati.

#### **4.1.1 Gjeologjia**

Në pikëpamje gjeologjike kaskada e Lumit Mati vendsoset në të ashtuquajturën Zona Gjeologjike Mirdita, e cila njihet si Zona e Shkëmbinjve Magmatikë ose Zona e Ofioliteve. Kjo zone përhapet në jugë të prishjes tektonike transverasale Shkodra-Pejë. Në drejtimin verior, ajo mbihidhet në Zonën Cukali, dhe gjithashtu pjesërisht edhe mbi Zonën e Alpeve Shqiptare.

Shkëmbintë magmatike formojnë dy brerza me masive, një lindor dhe një perëndimor, dhe janë kryesisht të moshës Jurasike. Mirpo, për midis zones ka shkëmbinj efuzivë-sedimentarë të Triasik-Jurasikut dhe formacione sedimentare me përhapje mjaft të gjërë. Në zonën Mirdita përhapen gjithashtu disa pellgje mollasike të Miocenit sikurse është për shembull ai i Matit. Simbas Gjeologjisë së Shqipërisë (Meço, Aliaj, 2000) në këtë zone identifikohen dy zona seismogjene: Shkodër-Pejë transverse fault and Shkodra-Mati longitudinal zone.

Diga e Ulzësis është vendosur mbi shkëmbinj gabroidë të njësisë ofiolitike Jurasike, të cilat përcaktojnë kufirin perëndimor të një depresioni të gjërë të mbushur me sedimente mollasike Terciare (ranorë, konglomeratë, argjilite) dhe depozitime lumore Kuaternare. Depresioni përfaqëson një “strukture grabenore”, e cila formon një strukturë sinklinale të gjërë, e cila është formuar gjatë Terciarit nga prishje tektonike normale në kufitë e tij (Fig. 4.1). Një nga këto prishje normale me orientim VP-JL pret rezervuarin e Ulzës pikërisht në anën perëndimore të digës. Nuk është e qartë nëse këto prishje janë sot aktive në pikëpamje seizmike ose jo.




Figura 4 Harta gjeologjiko-tektonike e zonës Ulzë - Shkopet

#### 4.1.2 Ujrat sipërfaqësore

Pellgu i Lumit Mati përputhet me zonën ujëmbledhëse të Lumit Mati, e cila ka sipërfaqe 2,441 km<sup>2</sup>. Dega kryesore e Lumit Mati është Lumi Fan i cili rrjedh nga veri-lindja, ndërsa vetë Lumi Matit rrjedh nga jugë-lindja deri në bashkimin me Lumi Fan, dhe më tej rrjedh drejt perëndimit. Lumi Fan ka një sipërfaqe ujëmbledhëse prej 1,076 km<sup>2</sup> dhe formohet nga dy degë: Fani Madh dhe Fani Vogel.

Lumi Mati ka një rrjedhje mesatare vjetore 103 m<sup>3</sup>/s për vitet 1951-1985, nga të cilat 60 m<sup>3</sup>/s janë të lumit Mati vetë dhe 42 m<sup>3</sup>/s nga lumi Fan. Rrjedhja specifike rezulton rreth 40 l/s km dhe koeficienti i rrjedhjes është 0.75; këto të dhëna i përkasin të dy lumennjve Mati dhe Fan.

Këtu janë disa karakteristika bazë të lumit Mati:

- Volumi mesatar i rrjedhjes vjetore: 3,250 milion m<sup>3</sup>
- Rrjedhja specifike: 40.1 l/s/km<sup>2</sup>
- Raporti muaji më i lagur, Dhjetor, muaji më i thatë, Gusht: 10/1
- Prurja e lartë një here në 10 vjet: rreth 25 herë moduli i lumit
- Kapaciteti i grumbullimit të rezervuarit të Ulzës: 240 milion m<sup>3</sup> (rreth 15% e prurjes vjetore të lumit Mati)

### 4.1.3 Ujrat nëntokësore

Në pikpamje hidrogjeologjike pellgu i lumi Mat ndërtohet kryesisht nga tre tipe formacionesh shkëmbore: Shkëmbinj gëlqerorë të Mesozoit të cilët nëpërgjithësi janë intensivisht të karstëzuar dhe përmbajnë rezerva të mëdha ujrash nëntokësore; shkëmbinj magmatikë të çare me prodhueshmëri lokale deri të moderuar të ujrave nëntokësore, dhe depozitime mollasike të Nogjenit të cilat karakterizohen si shtresa ujëmbajtëse me prodhueshmëri të ulët.

Zona e digës së Ulzës përbëhet kryesisht nga shkëmbinj magmatikë ultrabazikë, që karakterizohen nga përshkueshmëria e cila lidhet me intensitetin dhe karakterin e çarjeve. Shkëmbinjtë magmatikë përmbajnë rezerva të vogla ujrash nëntokësore të cilat përdoren kryesisht për furnizime të vogla lokale. Në anën e sipërme të digaës së Ulzës përhapen kryesisht depozitime mollasike të cilat gjithashtu përmbajnë rezerva të vogla ujrash nëntokësore.

### 4.1.4 Cilësia e ujrave

Cilësia e ujrave sipërfaqësore është studjuar për disa seksione të Lumit Mati. Analizat janë kryer nga Instituti i Hidrometereologjisë i Tiranës dhe rezultatet e përgjithësuara për periudhën 1965-1980 janë përshkruar në monografinë "Hidrologjia e Shqipërisë" publikuar në vitin 1984. Ujrat e lumit Mati, të studjuara në stacionin hidrometereologjik në Shoshaj, janë të një cilësie shumë të mirë; uji është me mineralizim të ulët dhe fortësi të vogël dhe përta i përket joneve mbizotëruese uji është i tipit Bikarbonat-Kalciumi. Mineralizimi i Përgjithëshëm luhartet nga rreth 170 deri 250 mg/l dhe fortësia e përgjithëshme luhartet rreth 7 deri 10° Gjermane. Përta i përket mikrokomponentëve si për shembull metalet e rënda etj, përcaktimi i tyre nuk është kryer. Në zonën e studimit më pare kanë qënë aktive disa minjera bakri dhe kromi të cilat janë mbyllur rreth 15 vjet më pare ose punojnë me kapacitet shumë të reduktuar. Minjerat e bakrit vendosen në pellgun ujëmbledhës të Lumit Uraka (një degë e lumit Mat) dhe disa minjera kromi vendosen në pjesën më të sipërme të Lumit Mati. Do ishte me rëndësi të veçantë sikur të mateshe koncentrimi i bakrit dhe kromit në ujin e lumenjve Mati dhe Uraka si dhe në vetë Liqenin e Ulzës.

Kimia e ujrave nëntokësore është studjuar nga ish Ndërmerja Hidrogjeologjike. Ujrat nëntokësore të zones së Digave mbi lumen Mati kanë rezultuar me cilësi të mire; ato kanë mineralizim të ulët dhe janë me fortësi të ulët, tipi i tyre hidrokimik është Bikarbonat-Kalçiumi në shtresat ujëmbajtëse gëlqerore, Bikarbonat-Magneziumi në shkëmbinjtë magmatikë dhe Bikarbonat-Kalçium-Magneziumi në shkëmbinjtë mollasikë.

### 4.1.5 Ndotja e tokës

Tokat në zonën e Digës së Ulzës janë toka pyjore gri. Tokat pyjore gri janë tipike për brezin e maleve me lartësi mesatare dhe ato formohen në formacione shkëmbore tokë-formuese në saje të së cilës përbërja mekanike luhartet nga argjilo-ranore në ranore-argjilore, shpesh dhe me zaje. Vetëm tokat poshtë

digës janë ndikuar nga ndërtimi i digës në vitin 1958 si dhe nga ndërtimi i rrugës së shërbimit.

Tokat në zonën rrethe digës në fjalë nuk janë të ndoturanga lëndë toksike ose nga hedhurina.

#### **4.1.6 Cilësia e Ajrit the Burimet e Emetimit në Ajër**

Që nga ndërtimi i digës së Ulzës cilësia e ajrit i korespondon kushteve natyrore të mjedisit. Nuk ka as transport ndotësish nga një teritor në tjetrin. Trafiku i mjeteve motorike është i kufizuar dhe nuk paraqet ndonjë impakt të rëndësishëm për pastërtinë e ajrit. Pastërtia e ajrit favorizohet edhe nga mungesa e aktiviteteve industriale në zonë përjashtoj atë që lidhet me prodhimin e energjisë elektrike.

#### **4.1.7 Cilësia e Zhurmave**

Zona në studim ndodhet larg qendrave të banuara apo aktiviteteve industriale, ajo është kryesisht zone rurale. Niveli sfondit të zhurmave është praktikisht niveli i sfondit natyror të mjedisit dhe qëndron sigurisht nën 40 dBA. Niveli bazë i emetimit të zhurmave ngrihen në mënyrë të menjëhershme vetëm gjatë periudhave të shkurtëra të hapjes së portave dhe rrjedhjes së ujit, të cilat shqërohen edhe me ngritjen në mënyrë të ndjeshme të nivelit të zhurmave.

#### **4.1.8 Peizazhi**

Ndryshimi i mjedisit pamor në zonën që po marim në konsideratë tashmë ka ndodhur që me ndërtimin e Digës së Ulzës dhe formimit të Liqenit të Ulzës. Pylli i dushqeve i prerë gjatë fazes së ndërtimit të digës është pothuaj se i rikrijuar. Kjo është favorizuar edhe nga lëvizja masive demografike të popullsisë lokale nga fshatrat drejt qyteteve të mëdhenj të pjesës qendrore të Shqipërisë. Liqeni i Ulzës është tashmë një pjesë shumë e rëndësishme e peisazhit; liqeni artificial qëndron në harmoni të plotë me relievin kodrinor dhe malor që e rethon atë.

### **4.2 METEOREOLOGJI**

Diga e Ulzës ndodhet në Nën/Zonën Klimatike Mesdhetare Kodrinore Veriore (Ndarja Klimatike e Shqipërisë, në "Klima e Shqipërisë", publikuar nga Instituti i Hidrometeorologjisë i Tiranës, 1984). Ajo përfshin pjesën perendimore të zones malore të ulët të Shqipërisë Veriore e cila luhetet kryesisht në lartësitë nga 200 deri 600 m mnd. Kjo nën/zone karakterizohet nga dimër relativisht i ngrohtë dhe i lagësht dhe nga verë e thatë dhe e nxehtë. Përshkrimi i mëposhtëm i elementëve klimatikë bazohet në të dhënat e Stacionit Meteorologjik të Burrelit i cili është më i afërmi me Digën e Ulzës.

## 4.2.1 Temperatura

Dimri në këtë zonë është relativisht i ngrohtë dhe temperatura mesatare e Janarit është rreth 3.4°C (Tabela 4.1). Temperatura ditore mesatare minimale e Janarit është rreth -0.9°C, dhe temperatura ditore minimale absolute mund të ulet deri në -14°C. Temperatura ditore mesatare maksimale për Janarin është rreth 16.4°C.

Tabela 1 Temperaturat mesatare mujore në °C dhe rreshjet mesatare mujore në mm për Stacionin Meteorologjik të Burrelit

Elementët	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Mesatare
Temperaturat	3.4	4.8	8.0	12.6	16.2	20.1	22.7	23.2	19.6	14.3	9.7	5.6	13.4
Rreshjet	116	124	103	100	76	51	31	34	75	122	160	156	1148

Gjatë verës temperaturat mesatare ditore luhaten rreth 23°C. Temperaturat ditore mesatare për muajt Korrik dhe Gusht janë rreth 30°C, dhe temperaturat ditore maksimale absolute mund të mbrijnë deri në 38-40°C. Temperaturat ditore mesatare minimale janë rreth 16°C.

Pranvera është e freskët, me temperaturë mujore mesatare në muajt qëndrorë pranverorë rreth 12.6°C. Gjatë vjeshtës temperature mesatare bie nga rreth 19.6°C gjatë Shtatorit, dhe në rreth 9.7°C gjatë Nëntorit.

## 4.2.2 Rreshjet

Sasia vjetore e rreshjeve në zonën e studimit për periudhën 1931-1965 në Burrel është 1148 mm (Klima e Shqipërisë). Shumë karakteristike për klimën e Shqipërisë është shpërndarja jo-uniforme e rreshjeve; pjesa më e madhe e tyre (rreth 70 % e rreshjeve vjetore) bie në periudhën Tetor - Mars, kurse gjatë mujave të verës (Qershor - Gusht) bie zakonisht më pak se 10 % e rreshjeve vjetore (Table 4.1).

Rreshjet bien kryesisht në formë shiu, dhe rreshjet e borës përbëjnë më pak se 5% të rreshjeve vjetore.

Ngjarjet e rrebesheve janë një karakteristikë e klimës së Shqipërisë, por nuk ka regjistrime të kësaj dukurie për krejt territorin e vendit. Simbas disa të dhënave për Stacionin Meteorologjik të Shkodrës (më i afërti me Digën e Ulzës që ka të dhëna të tilla) rreshjet 15 minutëshe janë rreth 30 deri 40 mm, rreshjet 30 minutëshe mund të mbrijnë deri në 80 mm, ndërsa rreshjet për 1, 2 dhe 3 orë janë regjistruar përkatësisht 120 mm, 152 mm dhe 161 mm.

### 4.2.3 Ligjësitë e erës

Zona që po shqyrtojmë karakterizohet nga kushte të mira ajrimi. Simbas vërtetimit të kryer nga Instituti Hidrometeorologjik i Tiranës, drejtimet mbizotëruese të erës në Burrel janë në jugë, jugë-perëndim dhe perëndim gjatë të gjithë vitit. Shpejtësia mesatare mujore e erës është rreth 1.7 m/s. Shpejtësia më e madhe e erës e regjistruar në Burrel është rreth 35 m/s.

## 4.3 MJEDISI BIOLOGJIK

### 4.3.1 Flora

Flora dhe vegjetacioni i kësaj pjese të pellgut ujëmbledhës së lumit Mati përfaqësohet nga shkure dhe pyje të degraduar (Oakland of *Quercus pubescens* and *Carpinus orientalis*) dhe nga shkure gjithvjetore të gjelbërta ose nga shkurnaja Mesdhetre, të dominuara nga *Quercus ilex*, *Arbutus unedo*, dhe *Myrtis communis*). Asosacionet kryesore të pemëve që ndodhen në këtë zone janë: *Querceta pubescentis*, *Arbutea unedo*, *Querceta ilicis*, *Pistaceta lentiscus*, *Rhueta coriaria*, *Paliureta spina-christi*, *Carpineta orientalis*, *Ericeta arborea*, etc. Në Fig.4.2 tregohet pylli i dushqeve afër Digës së Ulzës.



Figura 5 Pylli i dushqeve në të dy anët e Digës së Ulzës

### 4.3.2 Fauna

Fauna e kësaj zone është tipike e shkurreve dhe pyjeve Mesdhetare. Nga mishngrënësit janë dalluar: *Sus scrofa*, *Capreolus capreolus*, *Vulpes vulpes*, *Meles meles*, *Martes foina*, *Mustela putorius*, *M. nivalis*. Një numër i madh i specieve të lakuriqëve ndodhen gjithashtu në zonën e studjuar (eg. *Rhinolophus rhinolophus*, *Rh. blasii*, *Rh. euryale*, *Myotis myotis*, *M. blythi*, *M. capaccinni*, *Miniopterus schreibersi*, *Vespertilio murinus*, *Nyctalus sp*, *Pipistrellus sp.div.* etc). Rezervuarët ujorë të Ulzës dhe Shkopetit janë një mjedis i mirë ushqimim për lundërzën Europiane (*Lutra lutra*).

Një komunitet relativisht i madh zogjsh ndodhet në shkuret dhe pyjet Mesdhetare, ndër të cilët dallohen qukapikët (*Dendrocopos sp.*, *Jynx torquilla*, *Picus canus*, *P. viridis*), disa lloje shikëla (*Perdix perdix*, *Coturnix coturnix*) dhe harabelash (*Parus sp*, *Fringila sp*, *Carduelis sp.*, *Emberiza sp.*, *Sylvia sp.*, *Sitta sp.*, *Lanius sp.*, *Turdus sp*, etc). Disa zoq akuatikë vizitojnë ujrat e rezervuarit të Ulzës, si *Podiceps nigricollis*, *P. cristatus*, *Tachybaptus ruficollis*, *Egretta alba*, *E.garzetta*, *Ardea cinerea*, *Larus ridibundus*, *Alcedo atthis* etc.

Nga zvaranikët dhe amfibët që ndodhen në zonën e studjuar, veçanërisht të lidhur me habitatatet akuatike janë dalluar *Emys orbicularis*, *Natrix natrix*, *N. tessellata*, *Triturus vulgaris*, *T.cristatus*, *Salamandra salamandra*, *Hyla arborea*, *Bufo viridis*, *B. bufo*, dhe specie të ndryshme bretkocash (*Rana sp.div.*)

Në ujrat e freskëta të liqenit të Ulzës dhe Shkopetit janë gjetur specie të ndryshme peshqish, si për shembull *Coregonus "forma hybrida"*, *Gobio gobio lepidolemus*, *Gobio gobio albanicus*, *Cyprinus carpio*, *Carassius auratus gibelio*, *Barbus meridionalis petenyi*, *Alburnus alburnus alborella*, *Nemachilus barbatulus*, *Anguilla anguilla*, *Hypophthalmichthys molitrix*, *Aristichthys nobilis*, *Pachychilon pictum*, etc, nga të cilat disa kanë rëndësi ekonomike dhe janë me interes për popullësinë lokale që jeton rreth rezervuarve.

### 4.3.3 Territoret Natyrore të Mbrojtura

Afër Digës së Ulzës nuk vendosen zona speciale të mbrojtura. Sikurse mund të shihet në "Harta e Zonave të Mbrojtura të Shqipërisë" (Fig. 4.3), diga e Ulzës vendoset larg zonave të mbrojtura. Megjithatë disa prej tyre sikurse është "Rezerva Natyrale e Menaxhuar e Lurës", dhe "Peisazhi i mbrojtur Malit me Gropa - Biza - Martanesh" vendosen praktikisht brënda pellgut ujor të lumit Mat.

Këto zona të mbrojtura vendosen kundër rrjedhjes kundrejt Digës së Ulzës dhe nuk mund të kenë ndonjë impakt nga aktivitetet që zhvillohen në digë.




Figura 6 Harta e Zonave të Mbrojtura të Shqipërisë (pjesa Veriore)

## 4.4 MJEDISI SOCIAL-KULTUROR

### 4.4.1 Aktiviteti Bujqësor dhe Blegtoral

Popullata e Komunës së Ulzës është mjaft e rrallë. Popullsia e përgjithshme e Komunës së Ulzës është rreth 2500 banorë. Popullsia e zonës po zvogëlohet krahasuar me atë që ka qënë para tranzicionit.

Aktiviteti kryesor ekonomik për popullsinë lokale është bujqësia dhe blegtoria. Toka është shpërndarë simbas ligjit No 7501, dhe çdo fermer ka marë 1 ha tokë bujqësore, e cila është e mjaftueshme për të përballuar nevojat e një familje, por krejtësisht e pamjaftueshme për të praktikuar bujqësi intensive. Mungesa e makinerive ka ndikuar në rënien e përgjithshme të bujqësisë. Si rezultat, tokat bujqësore shpesh përdoret vetëm për ushqimin e kafshëve shtëpiake.

#### **4.4.2 Të ardhurat, Standarti i Jetës**

Të ardhurat kryesore për popullatën rurale të Komunës së Ulzës vijnë nga punët në sektorin e bujqësisë, pjesërisht nga peshkimi, dhe nga imigrantët. Popullata rurale e zonës përballlet me një numër problemesh, sikurse janë mungesa e furnizimit me ujë dhe e sistemit të ujrave të zeza si dhe mungesa e një infrastrukture rrugore të përshtatëshme. Standarti i jetës i popullatës rurale të kësaj zone po rritet por nuk është në nivelet e përshtatëshme. Të rrinjtë në veçanti kërkojnë një të ardhme më të mirë në qytet dhe jo në sektorin e bujqësisë.

#### **4.4.3 Burime të Tjera të Ardhurash**

Fitimet nga aktiviteti bujqësor janë të pamjaftueshme për pjesën më të madhe të familjeve për të përballuar nevojat ditore të jetesës. Kjo është arsya që familjet kërkojnë të gjejnë burime të tjera të ardhurash. Burimi alternativ më i rëndësishme për familjeve të zonës janë të ardhurat nga migrimi afat-shkurtër dhe afat-gjatë, kryesisht në Greqi dhe në Itali. Këto të ardhura përfqësojnë rreth 30 % të të ardhurave mesatare mujore të familjeve. Të ardhura relativisht të mira për një numër të kufizuar banorësh vijnë nga peshkimi në Liqenin e Ulzës.

Në të kaluarën pyjet janë përdorur intensivisht për të siguruar dru zjarri dhe si material ndërtimi. Pyjet përfshijnë para së gjithash dushkun dhe ahun. Si rezultat i kësaj, shumë pyje lokalë janë degraduar gjatë 30 vjetëve të fundit në shkure jo produktive me vlerë tregëtare dhe biodiversitet të ulët.

## **5 LEGJISLACIONI NË FUSHËN E MJEDISIT DHE PROCEDURAT E MBROJTJES**

Aktivitetet e kryera në kuadër të Projektit të Mbrojtjes së Digave të Shqipërisë do përputhen si me Rregulloret Shqiptare të Mjedisit ashtu edhe me politikën Mbrojtëse të Bankës Botërore. Për këtë qëllim, ky Vlerësim i Ndikimit në Mjedis është përgatitur dhe është bazuar në Vlerësimin Mjedisor përfshi Planin e Menaxhimit të Mjedisit të përshkruar nga Banka Botërore. Qëllimi i kësaj VNM përfshin gjithashtu gjithë informacionet e kërkuara nga Ligji Shqiptar i VNM, në mënyrë më specifike informacionet e kërkuara për Raport-in mbi Përmbledhje për Vlerësimin Mjedisor.

### **5.1 PROCEDURA MBROJTËSE E BANKËS BOTËRORE**

Banka vlerëson çdo projekt në raport me politikën mbrojtëse. Projekti Shqiptar i Mbrojtjes së Digave në këtë mënyrë pasqyron politikën mbrojtëse të Bankës për vlerësimin mjedisor dhe sigurinë e digave. Shoshitja mjedisore e Bankës mund të klasifikojë projektet si kategoria A (impakte të rëndësishme mjedisore të padëshirueshme), kategoria B (impakte mjedisore më pak të padëshirueshme se ato të kategorisë A) dhe kategoria C (me impakt të padëshirueshëm minimal ose

pa impakte të pa dëshirueshme). Shohitja mjedisore e komponentëve të projektit ka përcaktuar se projekti mund të klasifikohet si kategoria B. Vlerësimi Mjedisor i bërë e konfirmoi atë si projekt cili nuk do ketë impakte afat gjatë të rëndësishme, të pakthyeshme ose që mbivendosen. Në fakt, VM identifikoi një numër impaktesh pozitive të projektit të propozuar dhe vetëm disa impakte të vogla negative të cilat mund të prvenohen plotësisht ose të reduktohen nëpërmjet aplikimit të veprimeve paraprake të përshtatëshme ose marjes së masave lehtësuese.

Vlerësimi Mjedisor (OP 4.01, BP 4.01, GP 4.01). Impakti mjedisor dhe shoqëror i Investimeve në Infrastrukturën Fizike në projektin e propozuar e merr parasysh këtë politike mbrojtëse. Meqënëse impakti i pa dëshëruar nuk do jetë shumë i rëndësishëm ose i pakthyesëm, atëhere, dhe sepse mund të mënjanohet ose reduktohet nëpërmjet masave të përshtatëshme mbrojtëse ose masave lehtësuese, projekti është klasifikuar si projekt i Kategorisë "B", i cili kërkon vetëm vlerësim të pjesëshëm mjedisor. Për të siguruar se këto tematika njihen si duhet, janë përshkruar dhe adresuar, VM-re janë përgatitur për nën-projekte të veçanta (diga). Ky VM, me PMM e saj siguron se do meren veprimet preventive të rekomanduara dhe masa lehtësuese, të cilat kënaqin këtë politikë mbrojtëse të Bankës.

Siguria e digave (OP 4.37, BP 4.37). Komponenti i projektit që përfshin masat përmirësuese për sigurinë dhe rregulloret e Digave e kaskadave në lumenjtë Drini dhe Mati përputhet me politikën mbrojtëse. Mirpo, kjo VNM, nuk adreson këtë çështje, sepse specialisti i Bankës për sigurinë e digave kreu një vlerësim të veçantë të sigurisë së digave në mënyrë që të sigurojë përputhjen e projektit me këtë politikë mbrojtëse.

## **5.2 LEGJISLACIONI SHQIPTAR PËR MJEDISIN**

Legjislacioni mjedisor përputhet me Ligjin mbi Mbrojtjen e Mjedisit No. 8934, datuar 5 Shtator, 2002. Ky ligj përcakton politikat kombëtare dhe lokale mbi mbrojtjen e mjedisit, kërkesat për përgatitjen e vlerësimeve të ndikimit në mjedis dhe vlerësimet strategjike mjedisore, kërkesat për aktivitetet e lejuara që ndikojnë në mjedis, parandalimi dhe reduktimi i ndotjeve në mjedis, normat dhe standartet mjedisore, monitorimi dhe kontrolli mjedisor, detyrat e organeve shtetërore në raport me problemet mjedisore, rolin e publikut dhe masat shtrënguese që vendosen kur shkelet Ligji.

Ligji mbi VNM, No.8990, është aprovuar më 23 Janar, 2003. Ai përcakton rregullat, procedurat dhe afatet për identifikimin dhe vlerësimin e impakteve direkte ose indirekte të projekteve ose veprimtarive në mjedis. Ligji përcakton shkallët e nevojshme për implementimin e procedurave të VNM: paraqitjen e aplikimit, shikimin paraprak, seleksionimin dhe klasifikimin e kritereve, këshillimin publik, të drejtën e informacionit, detyrimet dhe të drejtat e organizmave të tjera. Ligji gjithashtu përmban listën e veprimtarive që duhet të jenë subjekt i kryerjes së proceseve të Përmbledhjes së VNM së Thelluar.

Një VNM e thelluar (e avancuar) bëhet për projekte me impakte potenciale të mëdha, sikurse jepen në listen e Shtojcës 1 të Ligjit, ata projekte që jepen në listë në Shtojca 2 të cilën Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (MMPAU) konsideron se do kenë impakte të rëndësishme në mjedis (bazuar në informacionin e siguruar nga propozuesi në kohën e aplikimit, në mënyrën e detajuar në Shtojcë 3 të Ligjit), dhe në veprimtaritë që do implementohen në një zone të mbrojtur të Republikës së Shqipërisë.

Një Përmbledhje (përshkrim paraprak) i VNM EIA është kryer për projektet që mund të kenë impakte potenciale më të pa rëndësishme të cilat megjithatë kërkojnë një vlerësim ekspertit të impakteve të veta. Ato përfshijnë projekte e listuara në Shtojcën 2 të Ligjit mbi VNM, dhe çdo ndryshim ose përmirësimin të projekteve të vendosura në Shtojcën 1.

Ai (Ligji) mbështetet nga disa Vendime të Këshilit të Ministrave dhe të Rregulloreve të nxjera nga MMPAU. MMPAU është autoriteti legal kompetent për të kërkuar, rishikuar dhe për të miratuar dokumentat e VNM.

### **Vlerësimi i projektit sambas rregulloreve Shqiptare**

Simbas Shtojcës 1 të Ligjit mbi VNM i cili identifikon Veprimtaritë të cilat i nënshtrohen një Procesi të Thelluar/avancuar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, investimet e përshkruara nga Projekti i Sigurisë së Digave të Shqipërisë, nuk kërkojnë një proces të Thelluar të VNM. Për sa i përket projektit, Shtojca 1 përcakton se VNM e Thelluar nevojitet vetëm për ndërtimin e HC të reja.

Simbas Shtojcës 2 të Ligjit mbi VNM i cili identifikon aktivitetet që ndërmeren në Procesin e Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis, investimet e përshkruara në Projektin e Sigurisë së Digave të Shqipërisë, nuk kërkojnë ti nënshtrohen proceseve të VNM Paraprake , mirpo bazuar në artikullin 4 të Ligjit mbi VNM, i cili thotë se ndryshimet ose përmirësimi i projekteve të dhëna në Shtojcën 1 do ti nënshtrohet proceseve përmbledhse të vlerësimit të impaktit në mjedis. Meqënëse Shtojca 1 kërkon VNM për ndërtimin e HC, VNM paraprake kërkohet për çdo ndryshim ose përmirësim të HC egzistuese.

### **Vlerësimi Paraprak i Ndikimit në Mjedis**

Reporti i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis duhet të pregatitet nga njerëz nga persona fizikë ose juridikë të licencuar, të zgjedhur dhe të kontraktuar dhe të paguar nga propozuesi, në këtë rast KESH-i. Informacioni i shkurtër që duhet të duhet të përmbajë vlersimi paraprak i ndikimit në mjedis jepet në Shtojcën 2.

Kërkesa për miratimin e projektit me Raportin e Vlersimit Paraprak të Ndikimit, propozuesi (KESH) duhet ta paraqitë në Axhensinë Rajonale të Mjedisit (ARM) të rrethit ku projekti do të zbatohet. Brënda pesë (5) ditëve, ARM duhet ose ta miratojë ose duhet ta hedhë poshtë raportin. ARM mbas inspektimit në fushë të të dhënave të paraqitura në raport duhet të konsultohet me pushtetin vendor, me autoritetet e urbanistikës dhe turizmit dhe të pregatitë në formë të shkruar

justifikimin e opinionit të vet në favor të miratimit ose të refuzimit të projektit si dhe të propozojë kushtet që duhen për shënuar në dokumentat e miratimit dhe tja përcjellë këto kushte MMPAU brënda njëzet (20) ditëve kalendarike nga dita e kërkesës e pranimit për diskutim të materjalit. Ministri i Mjedisit do të caktojë një komision verifikimi i cili do propozojë vendimet.

Deklarata Mjedisore/ vendimi përmban: (a) Normat e shkarkimit të ndotsave të prishëm në ajër, ujë dhe tokë; (b) Masat detyruese bazuar në teknikat më të mira të mundshme për ndërtimin që parashikohet në projekt; (c) Masa detyruese për mbrojtjen e ajrit, ujit, tokës, biodiversitetit dhe të parandalohet transferimi i ndotjes nga një komponent imjedisit tek tjetri; (d) kërkesat për monitorimin e shkarkimeve që përcaktojnë metodologjinë e matjeve, dëndshmërinë e tyre, procedurën e vlerësimit dhe publikimin e rezultateve; (e) Kushtet për kufizimin e ndotjeve ndërkufitare mbi nivelet e lejuara; (f) Masa plotësuese për të penguar tejkalimin e normave të cilësisë të mjedisit; (g) Kërkesat për të raportimin dhe krahasimin e impakteve të caktuara gjatë përpilimit të raportit me efektet reale të zbatimit të projektit.

Në vazhdim të Ligjit mbi VNM, Republika e Shqipërisë që nga viti 2004 ka një Rregullore speciale për Pjesmarjen e Publikut në Proceset e VNM. Procedura e konsultimit me publikun për Vlerësimin Paraprak të Ndikimit në Mjedis e cila është përshkruar me detaje në kapitullin 10.

## **6 IMPAKTET MJEDISORE POTENCIALE**

Meqënëse objektivi i projekteve është që të sigurojë HC-et e Shqipërisë dhe të përmirësojë efektivitetin e tyre, është e rëndësishme që të nënvizohet që projekti do të ketë nëpërgjithësi një impakt pozitiv afat-gjatë në mjedis. Instalimi i paisjeve matëse do të kontribuojë në forcimin e rrjetit të vrojtimit meteorologjik dhe sistemi i grumbullimit të të dhënave do të sigurojë të dhëna në kohë-reale për sigurinë e digës dhe funksionimi i rezervuarit do reduktojë kohën e reagimit të emergjencës dhe do sigurojë një sistem të grumbullimit të dhënash të përpiktë dhe të qëndrueshëm. Sistemi i monitorimit së bashku me uljen e ndjeshme të riskut nga përmbytja dhe rezikimi i popullatës dhe i habitateve poshtë digës.

Mirpo, si edhe me çdo punë ndërtuese ose funksionim të njësive të mëdha, disa impakte negative në mjedis janë të pritshme. Impaktet që lidhen me veprimtarinë e projektit të përcaktuara në kapitullin 3 konsiderohen si direkte, afat-shkurtër, impakte t1 menjëherëshme efekti i të cilave prek vetëm sheshin e ndërtimit.

### **6.1 IMPAKTET MJEDISORE GJATE FAZËS SË NDËRTIMIT**

Impaktet mjedisore gjatë fazes së ndërtimit mund të lidhen vetëm me instalimin e paisjeve të monitorimit, dhe kështu janë kalimtare. Impaktet e tjera lidhen me ndotjen fare të vogël të ajrit për shkak të aktiviteteve të shpimit të cilat prekin punëtorët dhe pluhurin kur do transportohen paisjet dhe materialet e ndërtimit, prodhimi i mbetjeve (plehrave) kur të zëvendësohen paisjet e vjetra

monitoruese të cilat nuk funksionojnë, disa zhurma nga shpimi, dhe ndotje e tokës dhe ajrit nga lëvizja e materjaleve të dëmshme.

Pluhuri është një **bashkëushëtar** i transportit dhe grumbullimit të materjaleve të ndërtimit. Për të minimizuar pluhurin duhet të adoptohen masat e më poshtëme: kufizimin në minimum i intervalit të grumbullimit të materjaleve, të minimizohet ekspozimi kundrejt erozionit nga era, të përdoren kamionë të mbuluar për transportin, të reduktohet shpejtësia e mjeteve të transportit në sheshin e ndërtimit. Puntorët duhet të veshin paisje mbrojtëse gjatë shpimit.

Mbetjet e prodhuara gjatë instalimit të paisjeve lidhen me paisjet e vjetra të cilat do zëvendësohen. Këto janë zakonisht matryjal skrap, kablllo dhe pak beton. Këto mbetje janë klasifikuar sambas katalogut Europian të mbetjeve dhe të listës së lëndëve të dëmshme sepse Republika e Shqipërisë ka harmonizuar legjislacionin e mbetjeve me legjislacionin e KE: 17 01 01 beton, 17 04 05 hekur dhe çelik, 17 04 07 materjale të përzjera dhe 17 04 11 kablllo të tjera nga ato të përmendurat në 17 04 10. Saia e pritëshme e mbetjeve është e vogël. Këto plehra duhet ti dorëzohen kompanive të autorizuara për menaxhimin e mbetjeve dhe duhet të plotësohet dokumentacioni përkatës.

Sheshi i ndërtimit do të pastrohet dhe të gjitha hedhjet dhe materialet mbetës do të trajtohen në përputhje me klauzolat e specifikuar në faturat.

Djegja ose groposja ilegale e mbetjeve është e ndaluar pa lëshime.

Mbetjet komunale dhe mbetjet e tjera duhet të grumbullohen në kontenerë specialë për qëllimin në fjalë dhe të larhohen në mënyrë të rregullt.

Simbas Ligjit për trajtimin mjedisor të mbetjeve të forta personat fizike dhe juridike janë të detyruar të organizojnë monitorimin e tyre për sasinë e mbetjeve dhe ti depozitojnë me mjetet e tyre financiare dhe të paraqitin të dhënat e monitorimit çdo tre muaj në Axsensinë Rajonale të Mjedit.

Zhurma është një impakt i pa evitueshëm i mjedisit gjatë ndërtimit. Për fat të mirë, qendrat e banuara janë larg nga diga e Ulzës. Zhurma mund të kufizohet duke zbatuar praktika të mira menaxhimi (paisje të kalibruara) dhe kufizim të punimeve gjatë ndërtimit të turneve të punës.

Paisjet e ndërtimit duhet të përmbushin standartet e Diraktivave të KE 2000/14/KE të Majit 2000. Këto direktiva aplikohen për prodhimin e paisjeve që emetojnë zhurma. Të gjitha paisjet duhet të mirëmbahen në gadishmëri të mire pune.

Ndotja e tokës dhe e ujit nuk pritet sepse ajo mund të prevenohet. Mirpo, disa ngarkesa ndotjesh në ujë dhe në tokë mund të shkaktohen nga ndotje direkte ose indirekte nga shkaqe aksidentale ose trajtim jo të mirë të paisjeve ose të materjaleve të dëmshme. Të gjitha materialet duhet të çvendosen në përputhje me instruksionet që përfshihen në Njohuri mbi Sigurinë e Materjaleve e cila ndodhet pranë sheshit të ndërtimit. KESH-i ka përgatitur Planin e Veprimtimit për Prevenimin eDerdhjeve, Paisjet e KESH-it (Shtojca 3). Të gjithë punëtorët janë të familjarizuar me planin. Frekuenca e rekomanduar e inspektimit është një

here në muaj. Shënimet mbi inspektimin mbahen në Regjistrin e Informacionit Mjedisor. Regjistri përfshin shënimet mbi trainimet mjedisore dhe instruksjonet, çështjet shëndetësore të punonjësve përfshi dhe informacionet mjedisore mujore. Regjistri dërgohet çdo muaj në Njësinë e Menaxhimit të Njedisit në KESH. E njëjta praktikë duhet të vazhdohet gjithashtu gjatë fazes së ndërtimit.

KESH në bashkëpunim me HC e Ulzës përgatit planin e mbrojtjes së punëtorëve, duke përdorur praktika të mira dhe rregulla për realizimin e aktiviteteve në sheshin e digës.

## **6.2 IMPAKT MJEDISOR GJATE FAZËS SË FUNKSIONIMIT**

Impakti mjedisor gjatë fazes së funksionimit pothuaj nuk egziston. Gjatë mirëmbajtjes sasira të papërfillshme mbetjesh mund të krijohen si skrap metali në se do kërkohen zëvendësime. Funksjonimi i paisjeve monitoruese nuk krijon zhurmë, nuk përbën burim ndotjesh të tokës dhe ajrit.

## **7 PLANI I MENAXHIMIT TË MJEDISIT**

Plani i Menaxhimit të Mjedisit (PMM) përfshin masat kundrejt impakteve të mundshme gjatë aktiviteteve të përmirësimit dhe të funksionimit të HC të Ulzës. Plani i Lehtësimit me impaktet e identifikuar, masta dhe personat përgjegjës është paraqitur në taela 3 ndërsa Plani i Monitorimit për masat lehtësuese përfshihet në tabela 4.

KESH-i, HC i Ulzës dhe Inxhinieri Supervizues do të monitorojnë implementimin e PMM. Impakti i përgjithshëm i mundshëm mjedisor dhe i sigurisë është e mundshme të lehtësohen me anë të adaptimit të një praktike të mirë inxhinierike. KESH-i do sigurojë se dokumentat e kontratës përfshijnë edhe klauzolat e rëndësishme të mbrojtjes mjedisore. Kontraktori cili do realizojë punimet ndërtimore gjithashtu do respektojë kërkesat e rregulloreve aktuale Shqiptare të ndërtimit dhe mjedisit. Inxhinieri Supervizues do të supervizojë punimet e ndërtimit. Në përputhje me rregulloret Shqiptare dhe me kërkesat e PMM në fjalë do të monitorohet dhe verifikohet gjatë vizitave të rregullta në vend. Rezultatet e vizitave do raportohen çdo tre muaj në raportet e supervizionit që do i paraqiten KESH-it nga Inxhinieri Supervizues, bazuar në konsultimet edhe me Kontraktorin. Inxhinieri Supervizues do i kthejë vëmendje çdo çështjeje e cila mund të lindë gjatë punimeve ndërtimore dhe do informojë KESH-in dhe do sugjerojë veprime për agjensitë e ndryshme.

Njësia e menaxhimit të mjedisit e KESH-it me HC e Ulzës do të zbatojë gjatë punimeve masat lehtësuese të PMM. Njësitë kanë përvojë me zbatimin emasave të PMM sepse ajo po monitoron tashmë dy projekte të tjera që KESH-i ka me Bankën Botërore. KESH-i do raportojë Bankës dy here në vit gjëndjen e zbatimit të PMM.

Kontraktori do monitorojë dhe do zbatojë gjithë masat lehtësuese mjedisore, përfshi masat e sigurisë dhe shëndetit (mënjanimin e aksidenteve, etj.) dhe kontrollin e ndotjeve dhe mbetjeve në sheshin e ndërtimit dhe në kampin e ndërtimit. Vrojtimi gjatë fazës së funksionimit do të bëhet nga Njësia e

Menaxhimit të Mjedisit e KESH-it. Njësia e Menaxhimit të Mjedisit dhe stafi operues i HC të Ulzës, ose nga ndonjë kompani e licencuar dhe e kontraktuar në se do jetë e nevojshme. Do të realizohen supervizione çdo ditore e gjithë aktiviteteve për të siguruar se se janë përdorur praktikat e nevojshme mjedisore gjatë perjudhës së ndërtimit. Inxhinieri Supervizues do bëjë auditim tremujor të projektit të PMM që: a) të sigurojë se ajo është e përditëzuar dhe e përshtatëshme me situatën në vend;; b) të sigurojë se veprimet korigjuese dhe të pa përshtatëshme janë dokumentuar në mënyrë të plotë; c) të rishikojë gjendjen e zbatimit; dhe, d) të vlerësojë qëndrimet jo korekte të kontraktorit. KESH-i do raportoje rregullisht mbi progresin e zbatimit.

Të dhënat monitorimit do dërgohen një here në muaj në Njësinë e Menaxhimit të Mjedisit të KESH-it, dhe çdo tremujor në Axhensinë Rajonale të Mjedisit.

Monitorimi mjedisor dhe supervizioni do të integrohen në menaxhimin e projektit dhe në sistemin e raportimit. Autoritete të rëndësishme Shtetërore do të përfshihen në auditimin e realizimit të projektit dhe do marrin kopje të raporteve monitoruese. Tabela 3, dhe 4 përmbledhin aktivitetet monitoruese sambas këtij projekti dhe specifikojnë vendosjen e shesheve të monitorimit, dëndësin<sup>1</sup> dhe dhe kohëzgjatjen e monitorimit.

Tabela 2 Masta Lehtësuese Mjedisor për Fazën e Ndërtimit

Impakti për shkak të:	Masat Lehtësues të Impaktit	Koha dhe vendi	Fondet e realizimit	Personi përgjegjës	Funksjonet e kontrollit të kryera nga:
Ndotja e ajrit	<p>Pluhuri nga shkatërimi dhe transporti i materjaleve të ndërtimit dhe mbetjet do minimizohen nga përdorimi i ujit, nga zvogëlimi i shpejtësisë së mjeteve motorike dhe mbulimit të ngarkesave.</p> <p>Pluhuri në objekt mund të ndalohet po të jetë e nevojshme nëpërmjet mbulimi të sheshit të ndërtimit.</p>	Gjatë shpimit në vende të hapura dhe të mbyllura kryhen plasje	E pa rëndësishme Detyrim i Kontraktuesit transferuar sambas marveshjes ndërmjet HC Ulzë/KESH	Kontraktuesi	Inxhinieri Supervizues, KESH PIU, REA Inspektimi, EMU i KESH
Prodhimi i mbetjeve	<p>Kontraktori duhet të zbatojë proçdurat e menaxhimit të mbetjeve, kjo përfshin grumbullimin, dorëzimin e mbetjeve kompanive të autorizuara për menaxhimin e mbetjeve të dëmshme dhe plotësimin e dokumentacionit shoqëruës.</p> <p>Sheshi i ndërtimit do të pastrohet dhe gjithë mbeturinat dhe materialet e hedhura do të depozitohen në përputhje me klauzolat e specifikuar në faturat e pagesës.</p> <p>Djegia ose depozitimi ilegal i plehrave është i ndaluar reptësisht.</p>	Gjatë gjithë kohë së ndërtimit	Detyrim i Kontraktuesit transferuar sambas marveshjes ndërmjet HC Ulzë/KESH	Kontraktuesi	Inxhinieri Supervizues, KESH PIU, REA Inspektimi, EMU I KESH
Zhurma	<p>Koha e punës është nga 7.00 e mëngjesit deri 7.00 mbas dite.</p> <p>Të respektohen gjithë masat e pëgjithshme parandaluese për lehtësimin e zhurmave në sheshin e ndërtimit (atestuar me paiseje). Paisjet e ndërtimit duhet të respektojnë standartet që aplikohen sambas Direktivave të</p>	Gjatë gjithë kohë së ndërtimit	Pjesë e praktikës së rregullt të kontraktuesit	Detyrim i Kontraktuesit transferuar sambas marveshjes ndërmjet HC Ulzë/KESH	Inxhinieri Supervizues, KESH PIU, REA Inspektimi, EMU I KESH

	KE 2000/14/KE Maj 2000.				
Shqetsime trafiku	<p>Megjithëse kjo është një zone pak e populluar dhe nuk do ketë shumë shqetësim nga trafiku është e rëndësishme që menaxhimi i trafikut është përshkruar dhe kryer në përputheje me ligjet e vendit me masa të përshtatëshme dhe me sistem sinjalizimi (me ndriçim të përshtatshëm, shenja mbrojtëse të trafikut, pengesa dhe persona me flamur) të cilët shihen dhe respektohen me lehtësi</p> <p>Shpejtësia e lëvizjes duhet jetë lehtësisht e dukshme.</p>	Në rrugën lidhëse gjatë perjudhës së ndërtimit	Pjesë e praktikës së rregullt të kontraktuesit	kontraktuesit	Inxhinieri Supervizues, KESH PIU, REA Inspektimi, EMU I KESH

Table 3 Plani I Menaxhimit të Mjedisit

Faza	Cili është parametri që do monitorohet?	Ku do monitorohet parametri?	Si do monitorohet parametri? Tipi i paisjes monitoruese.	Kur do monitorohet parametri? (në çfërë intervalesh apo vazhdimisht)	Fondet e kërkuara /Kosto/	Organizata e ngarkuar me monotorimin
Ndërtimi	Shqetsimet nga trafiku	Në rrugët lidhëse	Vrojtime vizuale	Në vazhdimësi	Pjesë e kontratës me inxhinierin supervizues	KESH PIU, NjMM, HC Ulzë
Ndërtimi dhe funksionimi	Ndotja e ujit dhe tokës nga derdhjet prej depozitave të pa mbyllur mirë, nga menaxhimi dhe përdorimi i materjaleve	Në sheshin e ndërtimit dhe në sheshin e funksjonimit	Vrojtime vizuale Shënime sambas trainimit	Në vazhdimësi (regjistrime mujore)	Pjesë e kontratës me inxhinierin supervizues gjatë ndërtimit dhe nga stafi operativ gjatë funksionimit	KESH PIU, NjMM, HC Ulza

<i>Ndërtimi dhe funksionimi</i>	<b>Prodhimi i plehrave</b>	Në sheshin e ndërtimit dhe në HC gjatë funksionimit	Nga njoftime (tabela) mbi plehrat dhe shënime mbi prodhimin e plehrave, grumbullimin dhe depozitimin  Vrojtime vizuale	Vazhdimisht gjatë ndërtimit dhe funksionimit (regjistrime mujore)	Pjesë e kontratës me inxhinierin supervizues gjatë ndërtimit dhe nga stafi operativ gjatë funksionimit	KESH PIU, EMU, HPP Ulza
<i>Funksionimi</i>	<b>Paisja monitoruese e montuar</b>	Atje ku është vendosur paisja e re monitoruese ose do vendoset	Piezometra, drenimi / paisje për matjen e filtrimeve, celula të presionit teporeve, etj.	Vazhdimisht, kjo për shembull do jetë, sasia që kullon nga muret e galerive dhe nga pjerësitë mbështetëse, cilësia kimike e ujit të grumbulluar, rezultatet nga piezometrat, etj.	Kosto e ndjeshme, pjesë e funksionimit normal të digës dhe pjesë e masave të rregullta siguroese	HPP Ulza, KESH EMU
<i>Funksionimi</i>	<b>Sistemi i alarmit</b>	Në gjithë sistemin e digës	Teste të rregullta mbi funksionimin e sistemit paralajmërues janë të rëndësishme, për sa i përket banorëve që lajmërohen paraprakisht, dhe mund të ndërthuren me prova evakuimi.	Do mvaret nga sugjerimet e planit të veprimit të emergjencës që do përpilohet	Mund të jetë një kosto mjaft e ndjeshme	HPP Ulza, KESH EMU

## 8 KAPACITETI INSTITUCIONAL

Që nga viti 2003, në KESH po funksionon një Njësi e Menaxhimit Mjedisor. Njësia po rrit kapacitetet e mbrendëshme për të përballuar programin mjedisor të shëndetit dhe të sigurisë në gjithë pjesët e tij përbërse. Zbatimi i projektiteve është bërë në përputheje me standartet mjedisore të Komunitetit Evropian, procedurat mbrojtëse të Bankës Botërore dhe parimet ISO 14001.

KESH-i gjithashtu ka zbatuar tashmë dy projekte të financuara nga Banka Botërore: Projekti i termocentralit të Vlorës i financuar bashkarisht nga IBRD dhe EBRD dhe nga Projekti i Rhabilitimit, dhe Përmirësimi dhe Zhvillimi i Sistemit Qëndror të Trasmimit të Energjisë I financuar vetëm nga IBRD.

Njësia e Menaxhimit të Mjedisit ka zhvilluar një politikë mjedisore e cila siguron drejtimin e performancës mjedisore nëpërmjet njësive të KESH-it. Politikat mjedisore sigurojnë zbatimin e masave paraprake për pengimin dhe lehtësimin e ndotjes, përmirësimet e vazhdueshme nëpërmjet trainimeve efektive dhe rritjes së kujdesit (vëmendjes) dhe shkarkimi brënda limiteve/pragjeve të caktuara.

Implementimi i politikës mjedisore sigurohet nëpërmjet programeve të menaxhimit të mjedisit dhe planeve të veprimit. KESH-i ka përpunuar a) Planin Veprimit për Parandalimin e rrjedhjeve, Konrolli dhe Kundërmasat për Paisjet e KESH-it (shtojca 3), b) Planin i Veprimit të Emergjencës (shtojca 4), dhe c) Planin i Veprimit për Mbetjet e Dëmshme (shtojca 5).

Në përputhje me këto plane HC do mirëmbajë Regjistrin e Informacionit Mjedisor. Regjistri përfshin trainimet dhe instruksionet mjedisore, problemet shëndetësore të punonjësve dhe Informacionet mujore mjedisore. Regjistri i dërgohet çdo muaj Njesisë së Menaxhimit Mjedisor të KESH-it.

Në përputhje me Ligjin mbi Mjedisin KESH ka detyrimet e mëposhtëme:

- Zbatimi i të gjitha masave të mundëshme që pengojnë shkarkimet ndotëse dhe ndotjen e mjedisit.
- Pengimi dhe reduktimi i plehrave atëhere kur përdorimi i tyre nuk është teknikisht dhe ekonomikisht i mundshëm, neutralizimi i tyre, nëpëmjet mënjanimi dhe reduktimin e impaktit të tyre në mjedis.
- Mënjanimi i aksidenteve industriale dhe kufizimi i pasojave të tyre.
- Rindërtimi i sheshit deri në kushtet mjedisore të kënaqëshme, mbas përfundimit të aktivitetit.
- Informimi mbi çdo ndryshim të planit të linjës teknologjike.
- Informimi i Axhensisë Rajonale të Mjedisit, jo vetëm një here në tre muaj mbi rezultatet e monitorimit por në çdo kohë edhe mbi aksidentet ose situatat emergjente, të cilat kanë ndikim të kundërt në mjedis.
- Respektimi i kërkesave të Inspektoriatit Mjedisor kur kontrollohen aktiveitete e tyre.

- Informimi i publikut mbi gjendjen e mjedisit dhe profilit mjedisor mbi aktivitetin e tyre.
- Mbajta e regjistrit mbi shkarkimet në mjedis, përdorimin e ujit dhe energjisë dhe teknikat e përdorura.

Kontrolli i gjendjes së mjedisit është detyrë e Inspektoriatit Mjedior, të firmosur nga Ministri i Mjedisit, dhe nga Axhensia Rajonale e Mjedisit.

Axhensia Rajonale e Mjedisit ka një rol në monitorimin dhe zbatimin e projektit mbasi procesi i VNM ka përfunduar. Simbas Ligjit mbi Mbrojtjen e Mjedisit, KESH do informojë Axhensinë Rajonale të Mjedisit, jo më pak se një herë në tre muaj rreth rezultateve të vetë-monitorimit dhe në çdo kohë, rreth aksidenteve ose situatave emergjente, të cilat kanë efekte të kundërta në mjedis.

Inspektoriati Mjedisor gjithashtu bën vizita të here pas here në shesh dhe kontrollon aktivitetet të cilat bëhen në përputheje me legjilacionin mjedisor dhe vendimet të VNM. Inspektimi mund të mbyllë, të pezullojë ose të ndalojë plotësisht aktivitetin e personave fizikë ose juridikë, të cilët kanë shkaktuar ndotjen mjedisor ose e kanë dëmtuar dhe përcaktojnë detyra të rëndësishme për përmirësimin e situatës. Përshkrimi i detyrimeve për organet shtetërore në lidhje me kontrollin mjedisor është përshkruar në shtojca 6.

## **8.1 FORCIMI I KAPACITETIT INSTITUCIONAL PËR PROJEKTIN**

KESH-i si investitor është përgjegjës për zbatimin e masave të përcaktuara të planit të monitorimit. Masat monitoruese të përcaktuara me vendim ministerial do të përfshihen në lejen e vendodhjes dhe ndërtimit.

Në mënyrë që të zbatohen në mënyrë të plotë aktivitetet e ndryshme mjedisore (veprimet preventivuese, masat lehtësuese dhe monitoruese) të rekomanduara në këtë VNM, KESH do mbështetë forcimin e NjZP si dhe kontraktorin dhe zbatuesin.

KESH-i do caktojë një person nga Njësia e Menaxhimit të Mjedisit në Njësinë e Zbatimit të Projektit. Ky person do bëjë vizita tremujore në shesh gjatë fazës së ndërtimit në mënyrë që të mbledhë informacion mbi monitorimin për Axhensinë Rajonale të Mjedisit si dhe për raportet mbi realizimin e projektit. Kur është e nevojshme personi do i bashkëngjitet misionit të Bankës.

KESH nëpërmjet marveshjes kontraktuale transferon tek kontraktori përgjegjës në zbatimin e masave lehtësuese dhe monitorimin gjatë fazës së ndërtimit. KESH do përcaktojë në kontratën e ndërtimit detyrimet mbi raportimin. Përgjegjësia ligjore për zbatimin do mbetet tek investitori (KESH). Për të lehtësuar procesin, KESH do të organizojë një kurs një ose dy ditor për firmën ndërtuese, ku do identifikojë qartë përgjegjësitë dhe detyrimet e raportimit. Firma ndërtuese do të raportojë tek NJZP çdo tre muaj mbi çështjet mjedisore. Ekipi i Kontraktorit do emërojë një person përgjegjës për problemet mjedisore gjatë fazës së ndërtimit.

Inxhinieri supervizues në shesh i seleksionuar si palë e pamvarur do raportoje gjithashtu në KESH për çdo çështje lidhur me VM dhe PMM. Inxhinieri Supervizues në shesh do ndihmojë HC e Ulzës/KESH-in në monitorimin e aspekteve mjedisore të projektit gjatë punimeve të ndërtimit. Inxhinieri supervizues do i shpjegojë kontraktuesit përgjegjësitë e veta për realizimin e planeve të lehtësimit të përfshira në kontratë. Për më tepër, Inxhinieri Supervizues do jetë përgjegjës përr: (i) plotësimin e raporteve të monitorimit me të dhënat mbi zbatimin e PMM gjatë kryerjes së punimeve; dhe (ii) marjen në kohë të masave në rast të mos përputhjes së masave të sugjeruara nga PMM përfshi tregues të ndonjë ndryshimi të PMM dhe të veprimeve specifike lehtësuese që janë marrë ose që është e nevojshme të meren.

KESH do organizojë trainime të vazhdueshme vjetore të stafit zbatues mbi legjislacionin mjedisor, përfshi familjarizimin e tyre me INM. KESH-I do emërojë një person në HC e Ulzës që të jetë përgjegjës për çështjet mjedisore gjatë funksionimit.

KESH do i raportoje rregullisht Bankës ecurinë e zbatimit të masave mjedisore dhe monitorimit nëpërmjet raporteve të ecurisë. Raporti gjysëm vjetor që ë paraqitet Bankës do përfshijë aspektet dhe aktivitetet e supervizionit sikurse është parashikuar në PMM në përputheje me ligjet Shqiptare: (i) Supervizioni mbi impaktet e mundëshme mjedisore gjatë fazes së ndërtimit përfshi zhurmat e ndërtimit, cilësinë e ajrit, etj.; (ii) verifikimin e përgjegjësisë së kontraktorit mbi mbledhjen e të dhënave të monitorimit dhe mbi mirëmbajtjen e përgjithëshme të sheshit në raport me masat e mbrojtjes mjedisore; (iii) egzistenca e planit të sigurisë në punë, plani i menaxhimit të mbetjeve dhe të planit të veprimit të emergjencës në shesh (gjatë realizimit të punës), plani i veprimit mbi rrejedhjet dhe lejeve mjedisore të vlefshme dhe dokumentave përkatës për realizimin si duhet të punës; (iv) Supervizioni i gruposjes së rregullt të mbetjeve të prodhuar në përputhje me rregullat shtetërore; (v) Monitormi i masave lehtësuese të impaktit të ndikimit në mjedis në sheshin e ndërtimit (si zhurmat e ndërtimit; vlerësimi i shpejtë i impakteve afat-shkurtër gjatë ndërtimit në ujrat sipërfaqësore); (vi) Vizita inspektimi dhe përfundimet.

Kontrolli i realizimit të detyrimeve nga VNM do të kryhet edhe nga Inspektorët e Axhensisë Rajonale të Mjedisit nëpërmjet vizitave të pa njoftuara.

Tabela 4 Përgjegjësitë për mjedisin gjatë ndërtimit dhe funksionimit

<i>Përgjegjësitë për lehtësimin dhe vrojtimin</i>	<i>Informacioni mbi Mjedisin (raportimi)</i>	<i>Zinxhiri i komandimit të vendim-marjes për menaxhimin e mjedisit (për kryerje veprimesh, për autorizimin e kontrolleve, ndalimin etj.,)</i>	
		<i>Veprimtari</i>	<i>Përgjegjësitë Institucione ose persona</i>

<b>Gjatë ndërtimit:</b>			
KESH HC Ulzës Kontraktori	Inxhinieri Supvizues i PIU / Njësia e Menaxhimit Mjedor të KESH-it pranë Akhensisë së Mjedisit	Monitorimmi i zbatimit të PMM dhe kushteve të VNM	Inxhinieri Supervizues, personi i ngarkuar nga KESH-i  Inspektoriati i Mjedisit i Akhensisë Rajonale të Mjedisit
<b>Gjatë funksionimit:</b>			
KESH HC Ulzës	HC Ulzës Njësia e Menaxhimit Mjedor të KESH-it pranë Akhensisë së Mjedisit Njësia e Mjedisit pranë Akhensisë Regjionale të Mjedisit	Monitorimmi i zbatimit të PMM dhe kushteve të VNM	Personi i ngarkuar nga HC Ulzës dhe skuadra mjedorore e Njësisë së Menaxhimit të Mjedisit  Inspektoriati i Mjedisit i Akhensisë Rajonale të Mjedisit

## 9 PJESMRJA E PUBLIKUT

Pjesmarja e publikut për projektin e Sigurisë së Digave të Shqipërisë do realizohet sambas procedurave si të Shqipërisë ashtu edhe të Bankës Botërore.

Në përputhje me politikën e Bankës Botërore për Vlerësimet Mjedorore, për gjithë projektet e Kategorisë B të propozuara sambas finacimit IDA, gjatë procesit të Vlerësimit Mjedor, huamarrësi konsulton grupet që ndikohen nga projekti dhe organizatat jo qeveritare lokale (OJQ) rreth aspekteve mjedorore të projektit dhe merr mendimin e tyre të paktën një herë. Huamarrësi inicion konsultime të tilla sa më shpejt që të jetë e mundur. Në vijim, huamarrësi konsultohet me grupe të tilla gjatë gjithë zbatimit të projektit duke i shpjeguar qështjet e vlerësimit mjedor që ju interesojnë atyre.

Konsultimet me publikun mbi VNM në Republikën e Shqipërisë janë përcaktuar nga Ligji mbi VNM si dhe nga Rregullore të posaçme mbi Rregullat e Pjesmarjes së Publikut në Procesin e VNM.

Projekti dhe raporti i vlerësimit të impaktit në mjedis do ti nënshtrohet një konsultimi publik. Konsultimi duhet të organizohet nga qeveria vendore ku projekti do zbatohet në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit/Akhensinë Rajonale të Mjedisit dhe propozuesit. Qeveria vendore do ftojë të interesuarit, vë në dispozicion raportin e VNM, në koperim me MMPAU/ARM vendosin mbi datën për diskutim dhe njoftojnë pjesëmarësit për ditën, kohën dhe vendin e mbledhjes. Përmbledhja e VNM duhet të jetë në dispozicion të të interesuarve 4 javë para mbledhjes.

Bazuar në rregulloren, projekti nuk duhet të paraqitet për procedurën e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis në qoftëse propozuesi nuk ka bërë konsultim me publikun. Propozuesi në koperim me Axhensinë Rajonale të Mjedisit do përpilojë një plan për konsultimin me publikun me kërkesa konkrete dhe me afate për kryerjen e tyre.

Plani do përfshijë: a) Identifikimin e mbështetësve (të interesuarit), b) Metodrat që do përdoren për pjesmarjen e publikut dhe do argumentojë pse pikërisht këto metoda janë zgjedhur, dhe c) grafikë (figura) për konsultimin me publikun.

Propozuesi informon publikun mbi sa më poshtë: a) Sheshin e vendin e zbatimit të projektit; b) Tipi i aktivitetit; c) kapaciteti teknologjik; d) në se është e mundur mbi lëndët e para, energjia, uji që do përdoret; e) Kohëzgjatja e projektit; f) Mbetjet (plehurat) që do prodhohen, tipi dhe mundësisht sasia; g) Impakti negative në shëndetin dhe mjedisin (ujin, ajrin dhe tokën/shkarkimet në tokë) f) Matja që duhen marrë për kufizimin e tyre.

Koha e propozuar për konsultim e cila përfshin si Shqipërinë edhe Bankën Botërore është si më poshtë:

Prill 24, 2008	KESH publikon kopje-Projektin (draft Projekt) e VNM në website, dhe kërkon komentet e palëve të interesuara  KESH i dërgon bashkive ku vendoset VNM kopje të elektronike dhe të printuara të raportit, të cilat qeveria vendore i publikon në dhe u dërgon kopje të interesuarve për komentim.
Prill 24, 2008 - May 10, 2008	KESH-i punon me ARP dhe me pushtetin vendor mbi konfirmimin mbi kategorinë e dokumentit dhe përgatitjen e planit e paraqitjes/konsultimin publik
Maj 10, 2008	Përfaqësuesi i pushtetit 10 ditë para njofton pjesmarrësit për ditën, kohën dhe vendin e mbledhjes mbi konsultimin
Maj 19-21, 2008	KESH së bashku me qeverinë vendore dhe MMPAU/ARM organizojnë paraqitjen në publik dhe konsultimin mbi projektin në njësinë vendore të interesuar.
Maj 26, 2008	KESH i paraqit Ministrisë dokumentacionin për sa më poshtë: (a) konkluzionet e takimeve të organizuara (proces verbal), (b) Përmbledhjen e mendimeve dhe komentet e publikut gjatë paraqitjeve, (c) rekazimet nga media elektronike dhe e shkruar.
June 1, 2008	raporti përfundimtar i cili reflekton komentet nga publiku i dërgohet Bankës dhe MMPAU/ARM për miratim.

# 10 SHTOJCAT

## 10.1 SHTOJCA 1 VIZATIME SKEMATIKE TË HC TË ULZËS

### 3 MAT RIVER CASCADE

#### 3.1 Ulza HPP




Fig. 29: Layout of Ulza HPP. ①: concrete gravity dam, ②: spillway, ③: power waterway intake, ④: Mat River, ⑤: reservoir, ⑥: switchyard.




Fig. 30: Cross section of Ulza Dam. ①: intake, ②: spillway gate, ③: pressure pipes, ④: power house, ⑤: downstream channel, ⑥: hoisting device, ⑦: gantry crane, ⑧: valve chamber, ⑨: control galleries, ⑩: flip bucket.

## SHTOJCA 2 PËRMBAJTJA E RAPORTIT TË VNM

Përmbajta e raportit mbi vlerësimin e impaktit mjedisor përmabn informacion të shkurtër mbi sa më poshtë:

- a) Objektivat e projektit;
- b) Përshkrimi i detajuar i objektivave;
- c) Të dhëna mbi mjedisin e zones ku do zbatohet projekti dhe në afërsi të saj;
- d) Përshkrim i detajuar i gjithë instalimeve që janë pjesë e projektit ose do të përdoren gjatë zbatimit të tij;
- e) Plani i ndërtimit dhe afatet e zbatimit të tij;
- f) Përshkrimi i vlerave të asaj sa është ndërtuar ose zgjeruar dhe punimet e nevojshme për zbatimin e projektit;
- g) Impakti i mundëshëm në mjedis dhe masat e propozuara për të parandaluar ose amortizuar këto impakte;
- h) Programi i monitorimit të impaktit të projektit në mjedis;
- i) Përputhja e projektit me planin e zhvillimit territorial dhe me planin e zhvillimit ekonomik të zones ku zbatohet projekti;
- j) Përmbledhja e konsultimeve me organet e pushtetit vendor, publikun dhe organizatave mjedisore jo-fitim prurëse dhe gjykimet e tyre;
- k) Masat rehabilituese në rast ndotjesh dhe dëmtim të mjedisit si dhe kostoja e tyre;
- l) Një kopje e liçencës e personit fizik apo juridik i cila ka përgatitur impaktin e ndikimit në mjedis.

## **10.2 SHTOJCA 3 PLANI I VEPRIMIT PER MENJANIMIN E DERDHJEVE, KONTROLLIN DHE KUNDER-MASAT PER PAISJET E KESH**

### **10.3 SHTOJCA 4 PLANI I VEPRIMIT TE EMERGJENCES**

## **10.4 SHTOJCA 5 PLANI I VEPRIMIT I MBETJET TE DEMSHME TE PAPARASHIKUARA**

## 10.5 SHTOJCA 6 ROLET DHE PERGJEGJESITE E ORGANEVE SHTETERORE TE LIDHURA ME MJEDISIN

### Rrjeta e institucioneve mjedisore

Gjithë organet e specializuara, të ngarkuara sambas ligjit me mbrojtjen e mjedisit në Republikën e Shqipërisë, përfaqësojnë rrjetën e institucioneve mjedisore të vendit.

Rrjeta e institucioneve mjedisore përfshin Mministrinë e Mjedisit, Axhensitë Rajonale të Mjedisit, Inspektoriatin Mjedor, organet mjedisore që mvaren nga autoritetet qëndrore dhe vendore, si edhe organizma ndër-ministeriale, të miratuara nga Këshilli i Ministrave për të ndjekur çështje mjedisore të rëndësishme.

Organet shtetërore qëndrore dhe vendore, si administratorë legjitimë të elementëve të ndryshëm mjedorë, realizojnë mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet zbatimit të këtij funksioni.

### Ministria e Mjedisit

Si një institucioni i specializuar në mbrojtjen e mjedisit si dhe si një organ mbështetës i Ministrit të Mjedisit kryhen këto detyra kryesore:

- Koperon dhe kordinon me institucionet shtetërore qëndrore, me publikun dhe me organizatat jo-fitimprurëse, për rritjen e nivelit të forcimit të legjislacionit mbi mjedisin.
- Prgatit propozim marveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe, protokollet, projektet dhe programet në koperim me qeveritë, me organet ndërkombëtare dhe organizatat për mbrojtjen e mjedisit dhe ndjek zbatimin e tyre.
- Studjon nevojat e vendit për specialistë dhe kordinon kualifikimin dhe aktivitetet specializuese të personelit që kanë të bëjnë me mjedisin, në koperim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.
- Mbështet projektet rreth kërkimeve shkencore, përmirësimin e gjendjes së mjedisit në vendi, futjen e teknologjive ekologjikisht të pastra dhe mbështet aktivitetet e organizmave jo-fitimprurëse.
- Ndhmon organet shtetërore të mbrojtjes së mjedisit në prgatitjen e planeve të veprimit të organeve vendore.

### Axhensitë Rajonale të Mjedisit

Axhensitë Rajonale të Mjedisit (ARM) janë organe të specializuara në mbrojtjen e mjedisit, që mvaren nga Ministria e Mjeditit dhe të cilat veprojnë në nivel

prefekturë. Ndërsa kur zbatohen objektivat dhe prioritetet e Ministrisë së Mjedisit, ARM-të:

- Realizojnë forcimin e legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit në nivel lokal (vëndor);
- Ndihmojnë organet vëndore shtetërore në fushën e mjedisit brënda zonës së veprimit të tyre; kopreojnë me pushtetin vëndor për zhvillimin e planeve vëndore të veprimit, programeve dhe projekteve
- Popullarizon përdorimin e teknologjive të pastra dhe futjen e sistemeve të mbrojtjes mjedisore;
- Përfshihen në procesin e miratimit të lejeve dhe deklaratave mjedisore, nëpërmjet zbatimit të detyrave që Ministri i Mjedisit jep në një rregullore të posaçme. Ato kryejnë mirkuptimet mjedisore dhe autorizimin për veprimtari lokale.
- Ndërmarrin veprimtari ndërjegjësimi për mbrojtjen e mjedisit dhe bashkëpunojnë me komunitetin, publikun dhe OJQ mjedisore dhe oranzata profesionale të biznesit.

#### Inspektoriati Mjedisor

Inspektoriati Mjedisor në kuadër të Ministrisë së Mjedisit vepron si një organ i specializuar në kontrollin mjedisor. Inspektoriati Mjedisor përbëhet nga: Shefi i Inspektoriatit, inspektorët e Ministrisë së Mjedisit dhe nga inspektorët e ARM. Inspektorët e Ministrisë së Mjedisit ushtrojnë veprimtarinë e tyre kontrolluese në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, ndërsa inspektorët e ARM vepron në brënda territorit të prefekturës.

Inspektoriati Mjedisor:

- Kruhen kontrolle të vazhdueshme në mjedis dhe në veprimtari të ndotëse në mënyrë që të garantojnë mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet forcimit të legjislacionit mbi mjedisin dhe kushteve të lejeve dhe të deklaratave mjedisore.
- Kërkojnë pjesëmarrjen e autoriteteve shtetërore vëndore, të përfaqësuesve të bashkive, të organizatave jo-fitimprurëse mjedisore dhe të medias gjatë kontrolleve të mjedisit.
- Krijon dosjet për çdo veprimtari e cila kryhet me leje mjedisore. Ministri i Mjedisit përcakton rregullat e detajuara mbi formën, përmbajtjen dhe administrimin e dojeve mjedisore.
- Ndihmojnë personat fizikë dhe juridikë të organizojnë vetë-monitorimin, verifikimin dhe zbatimin e sistemeve të menaxhimit të integruar dhe kontrollojnë zbatimin e tyre.

- Urdhërojnë zbatimin e masave të detyrueshme që duhet të meren për përmirësimin e mjedisit të vendit, për lehtësimin e ndotjeve dhe dëmtimin e mjedisit.
- Informojnë rregullisht autoritetet vendore mbi gjendjen e mjedisit, mbi miratimin e veprimtarive, projekteve dhe instalimeve, sambas dispozitave të këtij ligji.
- Kontrollon regjistrat e ndotsave, rregulloret e mbrendëshme, ato teknike dhe teknologjike dhe dokumenta të tjera që lidhen me veprimtari dhe risk ndotjesh.
- Vendos dënime (sanksione), sambas këtij ligji dhe sambas akteve të tjera ligjore të cilat mbrojnë përbërësit e veçantë të mjedisit.
- Publikon rezultate e çdo kontrolli të kryer.

#### Media publike

Media publike ndihmon në:

- mbrojtjen e interesave të vendit në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- ngritjen e njohurive të reja dhe të kulturës mbi mjedisin;
- realizimi i të drejtës të publikut për të qënë i informuar mbi gjendjen mjedisore të vendit;
- përhapjen e arritjeve teknike dhe shkencore në fushën e mjedisit dhe të veprimtarive kombëtare në këtë fushë.

#### Autoritetet shtetërore vendore

Autoritetet shtetërore vendore përfaqësojnë strukturën shtetërore më të rëndësishme për administrim dhe mbrojtjen e mjedisit që ato kanë nën juridiksion, nëpërmjet zbatimit të përgjegjësive, të drejtave dhe detyrave të njohura nga ligji No.8652, of 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e organeve vendore". Në fushën e mbrojtjes së mjedisit, ata kanë detyrat e më poshtëme;

- realizon dhe zbaton legjislacionin mjedisor;
- projekt planet lokale për mbrojtjen e mjedisit dhe planet për rregullimin e territorit;
- publikon programet dhe masat për mbrojtjen e mjedisit;
- informon publikun dhe shtetin për mjedisin, për veprimtaritë në shkallë vendore që janë pjesë e vlerësimit të impaktit mjedisor;
- drejton dhe mbështet aktivitete e organizatave jo-fitimprurëse për mjedisin, nëpërmjet tërheqjes së mendimit të tyre në procesin e vendim-marjeve mjedisore;

- përcakton sheshet e grumbullimit dhe përpunimit të prodhimit të mbetjeve urbane, në përputhje me kriteret mjedisore dhe planeve të zhvillimit;
- organizon depozitimin e mbetjeve dhe lëndëve të dëmshme si dhe mbrojtjen e sipërfaqeve të gjelbra në qendrat urbane dhe rreth tyre;
- administron mbetjet urbane, përpunimin e ujrve të zeza dhe të mbetjeve të forte;
- disiplinon edhe transportin dhe ndërtimet në mjedisin urban.